



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

DREJTIMI JURIDIKO - PENAL

TEZA E MAGJISTRATURËS:

**“DËNIMI ME BURG NË TERRITORIN E  
GJYKATËS THEMELORE TË TETOVËS PREJ  
VITIT 2007 DERI VITIN 2012”**

**KANDIDATI**

Ardijan Qazimi

**MENTORI**

Doc.Dr.Besa Arifi

Tetovë, Prill 2018

## PËRMBAJTJA

### “DËNIMI ME BURG NË TERRITORIN E GJYKATËS THEMELORE TË TETOVËS PREJ VITIT 2007 DERI VITIN 2012”

- HYRJE.....5
- QËLLIMET E HULUMTIMIT.....7
- METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....7

## KAPITULLI I PARË

### HISTORIKU I DËNIMIT ME BURGIM, PËRKUFIZIMI, QËLLIMI, LLOJET E TIJ NË KODIN PENAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.

1. HISTORIKU DHE EVOLUCIONI I DËNIMIT ME BURG.....9
2. PËRKUFIZIMI I DËNIMIT ME BURG.....15
3. QËLLIMI I DËNIMIT ME BURG SIPAS KODIT PENAL TË REPUBLIKËS MAQEDONISË.....18
4. DËNIMI ME BURG SIPAS KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.....20

## KAPITULLI I DYTË

### VËSHTRIME KRAHASUESE TË DËNIMIT ME BURGIM NË DISA KODE PENALE TË RAJONIT DHE MË GJËRË.

1. DËNIMI ME BURGIM NË KODIN PENAL TË KOSOVËS.....23
2. DËNIMI ME BURGIM NË KODIN PENAL TË SHQIPËRISË.....24
3. DËNIMI ME BURGIM NË KODIN PENAL TË SËRBISË.....26
4. DËNIMI ME BURGIM NË KODIN PENAL TË KROACISË.....27
5. DËNIMI ME BURGIM NË KODIN PENAL TË MALIT ZI.....28

## KAPITULI I TRETË

### ASPEKTET KRIMINOLOGJIKE TË DËNIMIT ME BURG.

#### 1. FENOMENOLOGJIJA E SHQYPTIMIT TË DËNIMIT ME BURG NË RRETHIN E GJYKATËS

##### THEMELORE TË TETOVËS GJAT VITEVE 2007 DERI VITIN 2012.

1.1.	ECURIA DHE DINAMIKA E DËNIMIT ME BURG.....	30
1.2.	LLOJET E VEPRAVE PENALE DHE LARTËSIA E SHQYPTIMIT TË DËNIMIT ME BURG.....	32
1.3.	MOSHA E TË DËNUARVE ME BURGIM.....	35
1.4.	GJINIA E TË DËNUARVE ME BURGIM.....	37
1.5.	NACIONALITETI I TË DËNUARVE ME BURGIM.....	39
1.6.	RECIDIVIZMI.....	41
1.7.	GJENDJA MARTESORE DHE STATUSI FAMILJAR.....	43

#### 2. ASPEKTI ETIOLOGJIK,SHKAQET QË KUSHTËZOJNË.

2.1.	SHKAQET APO FAKTORËT OBJEKTIV ( TË JASHTËM).....	45
2.1.1.	VARFËRIA DHE PAPUNËSIA.....	45
2.1.2.	FAMILJA DHE RRETHI FAMILJAR.....	46
2.1.3.	SHKOLLA SI FAKTORË OBJEKTIV I KRIMINALITETIT.....	49
2.2.	SHKAQET APO FAKTORËT SUBJEKTIV ( TË BRENDSHËM).....	50
2.2.1.	SHPREHITË.....	50
2.2.2.	INTELIGJENCA.....	51
2.2.3.	ÇRREGULLIMET MENDORE.....	53

## KAPITULLI I KATËRT

### MASAT PREVENTIVE DHE REPRESIVE PËR LUFTIMIN E KRIMINALITETIT.

1. MASAT PREVENTIVE.....	55
1.1.    EDUKIMI FAMILJAR.....	55
1.2.    ARSIMIMI.....	56
1.3.    MJETET E INFORMIMIT.....	58
2. MASAT REPRESIVE.....	59
2.1.    ROLI I POLICISË.....	59
2.2.    ROLI I PROKURORISË.....	61
2.3.    ROLI I GJYKATAVE.....	62
2.4.    ROLI I INSTITUCIONEVE KORREKTUESE.....	64
<b>PËRFUNDIMI.....</b>	<b>66</b>
<b>REKOMANDIMET.....</b>	<b>67</b>
<b>LITERATURA.....</b>	<b>68</b>

## HYRJE

Dënimi me burg është një ndër dënimet më të rënda dhe kryesore për ndëshkimin e kryerësve të veprave të rënda penale.

Prania e kriminalitetit në shoqërinë tonë që është evidente e që rezulton me burgimin e personave të dënuar me burg është problem kryesorë i shoqërive dhe shteteve bashkëkohore, duke marrë në suaza më të vogla edhe problem i gjitha komunave e në këtë rast me theks të veçantë në territorin e komunës së Tetovës. Kjo dukuri komplekse gjegjësisht dënimi me burg paraqet nevojën e hulumtimit dhe studimit të këtij faktori në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës, duke paraqitur gjendjen reale dhe njohjen e saj brenda territorit të caktuar.

Ky dënim në Kodin penal të Republikës së Maqedonisë- KPM ekziston në dy forma edhe atë në burg kohor të kufizuar dhe burg të përjetshëm. Sipas KPM-së ky dënim nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë por jo edhe më i gjatë se 20 vjet, që njihet si dënim me burg kohor të kufizuar. Nëse për vepra të rënda me paramendim është paraparë dënim prej 20 vjetëve, për format e rënda mund të shqyptohet edhe dënim me burg të përjetshëm. Alternativa për burgun e përjetshëm është edhe dënimi me burg deri 40 vjet .(bazuar në nenin 35 të KPM).

Nga pesha e rëndë që ka ky dënim ndaj kryerësve të veprave penale dhe rëndësia në sistemin shoqëror dhe institucional më ka shtyrë dhe nxit t'i qasem këtij hulumtimi me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe një kontribut sa do që i vogël mund të jetë, si dhe pyetjet që mund të lindin rreth shqyptimit të dënimit me burg dhe ekzekutimit në përgjithësi e konkretisht në territorin e Gjykatës së Tetovës.

Me anë të këtij punimi hulumtues do të mundësohet qasje dhe tretman në formën e dënimit me burg në Gjykatën e Tetovës si faktor adekuat për ndryshime në kualitetin e punës së gjykatës në tërësi , në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve me nevojat e mundëshme për ndryshime si parakusht per kualitetin më të lartë dhe efektiv të punës.

Ky punim shkencor në brendi do të përmbaj: hyrjen, përmbajtjen, kapitujt, përfundimin dhe literaturën e shfrytëzuar.

Në kapitullin e parë do të paraqesim historikun e dënimit me burgim, zanafilla dhe paraqitja e saj në fillimet e hershme , format dhe mënyrat e mbajtjes së dënimit me burg dhe trajtimi i të njejtës. Gjithashtu në këtë kapitull do të paraqesim përkufizimin , qëllimin dhe llojet e dënimit me burgim në kodin penal të Republikës së Maqedonisë.

Në kapitullin e dytë qëllim i këtij punimi shkencorë është paraqitja e dënimit me burg forma dhe rregullimi i saj sipas kodit penal të Republikës së Maqedonisë dhe krahasimi i të njejtës me shtetet e rajonit duke nxjerë, shikuar ngjajshmëritë dhe dallimet në mes veti.

Në kapitullin e tretë duke iu referuar evidencave dhe duke shfrytëzuar statistikat që mbahen në Gjykatën themelore të Tetovës për vitet 2007 deri vitin 2012 do të bëhet shikimi i të njëjtave duke i analizuar dhe do të paraqiten të dhënat e fituara në mënyrë statistikore.

Në kapitullin e katërt dhe të fundit qëllim kryesorë është paraqitja e masave preventive dhe represive për luftimin e kriminalitetit të cilat do të ndimojnë në zbutjen apo zvogëlimin e numrit të dënuarve me burgim.

## **QËLLIMET E HULUMTIMIT**

Me qëllim të ruajtjes së rendit juridik dhe shoqërisë në përgjithësi nga kryerësit e veprave të rënda , dënimi me burg është dënim me anë të së cilës bëhet parandalimi i autorit të mos kryejë veprë penale dhe gjithashtu duke ndikuar në riedukimin e tij, kurse nga ana tjetër ndikimi edukativ në ngritjen e vetëdijes mbi të tjerët të mos kryejnë vepra penale, me çka sipas KPM-së arihen dy qëllime, edhe atë: qëllimi retributiv- dënimi i kryerësit si formë e shpagimit dhe qëllimi edukativ – të tjerët të mësojnë nga këto raste.

Edhe qëllimi i këtij punimi shkencor do të jetë kontributi për ngritjen e vetëdijes më të lartë ndaj qytetarëve të Tetovës por edhe më gjërë dhe vënien në dukje të gjitha anëve pozitive dhe negative të dënimit me burg duke ofruar të dhëna statistikore nga evidencat dhe lëndët e marra nga arkiva e Gjykatës Themelore të Tetovës dhe nga enti për statistik për vitet 2007 deri vitin 2012.

Gjithashtu ky punim le të jetë porosi përcjellëse për respektimin e ligjeve pozitive dhe respektimin e të drejtave njerëzore , që të kemi përmirësime kualitative dhe rrënie të kësaj dukurie apo konkretisht ulje të dënimit me burg me qëllim të zhvillimit më të lartë institucional dhe ngritjes së vetëdijes më të lart tek qytetarët.

## **METODOLOGJIA E HULUMTIMIT**

Metodat që do të përdoren gjatë hulumtimit të këtij punimi shkencorë paraqesin procedur të veçantë për mbledhjen e të dhënave lidhur me fushën e cila shkencërisht gjurmohet. Për një punim shkencor të suksesshëm duhet të përcaktohen mënyrat dhe format e hulumtimit të cilat do të na shpiejnë në mënyrën dhe rrugën më të lehtë dhe më precize deri te informata adekuate për punimin shkencor, që në këtë rast është dënimi me burg. Metodat gërshetohen në mes veti duke e plotësuar njëra tjetrën dhe nga të dhënat e fituara realizohet qëllimi i pritur nga njëra te metoda tjetër.

Metoda kryesore që do të përdoret është **metoda normative**- që ka për qëllim njohjen e normës dhe jo ligjin, njohjen e një standardi apo mesatareje në botë që i nënshtrohet ndryshimeve të vazhdueshme e që në momentin apo fushën e caktuar është më e mirë. Kjo metodë më së shpeshti ka të bëjë me statistikat e ndryshme dhe të dhënat të cilat duhet të zbulohen dhe të interpretohen në mënyrë korrekte.

Si një ndër metodat që do të na shërbejë gjatë hulumtimit shkencorë do të jetë **metoda historike**- nëpërmjet të cilës jepet sqarim rreth këtij dënimi duke filluar prej zanafillës dhe të gjitha ndryshimet dhe format e paraqitjes që ka pësuar nëpër vite ky dënim.

Gjithashtu edhe **metoda krahasuese**- vlen të përdoret pasi me ndihmën e sajë do të bëjmë krahasimin e kodit penal gjegjësisht dënimit me burg të Republikës së Maqedonisë me kodet penale të shteteve të rajonit dhe shqyptimin e dënimit me burg nëpër periudha të ndryshme kohore prej vitit 2007 deri në vitin 2012 në territorin e Gjykatës të Tetovës.

Me anë të metodës **studimi i rastit**- metodë e cila do të na jep një pasqyrë më të përafërt pasi do të kemi të dhëna të sakta nga disa raste individuale nga Gjykata e Tetovës dhe të cilat do të përpunohen, klasifikohen dhe përmbledhen më saktësisht statistikat e shqyptimit të dënimit me burg krahasuar nga viti në vit, me qëllim të arritjes së një përvoje të dobishme.

Si metodë ndihmëse do të përdorim **metodën statistikore** me anë të cilës do të jepen të dhëna statistikore për rastet e kryerësve të dënuar me burgim në gjykatën e Tetovës gjatë periudhës kohore prej viteve 2007-2012.



## I - KAPITULLI I PARË

### 1. HISTORIKU DHE EVOLUCIONI I DËNIMIT ME BURG

Dënimi me burg mund të shqiptohet vetëm si dënim kryesorë, ku në sistemin e sanksioneve të shoqërisë bashkëkohore për krimet e rënda vend mjaft i rëndësishëm i takon kësaj forme të dënimit me heqje të lirisë apo me burgim. Të dhënat në literaturën juridike tregojnë se dënimi me burgim është mjaft i shpeshtë në praktikën gjyqësore të sistemit bashkëkohorë. Në kohën e vjetër dhe asaj të mesme ky dënim ishte mjaft i rëndë për shkak se bazohej në aplikimin e dënimit me vdekje, dënime trupore dhe në tortura të ndryshme fizike, që në krahasim me kohën bashkëkohore është arritur një humanizëm i lartë nëpërmjet ideve filozofike, shkollave dhe parimeve themelore që këto dënime të rënda janë zëvendësuar me dënime me burg apo heqje të lirisë. Para dënimit me burg si dënime kryesore për veprat e rënda ishin dënimi me vdekje, dëbimi, deportacioni, relegacioni, dënimet trupore, dënimet me punë të rënda fizike, dënimet morale, dënimet çnjerëzore dhe dënime pronësore<sup>1</sup>. Format e këtyre dënimeve ishin të rënda dhe të vrazhda ku qëllimi ka qenë pothuajse i njëjtë me sistemin bashkëkohor që të arrihet shpagimi dhe hakmarrja nga kryerësi i veprës nëpërmjet vuajtjeve të rënda fizike dhe psikike si dhe frikësimit e pjesëtarëve të tjerë të shoqërisë. Tortura ishte ndër dënimet më të shpeshta dhe forma e ekzekutimit ishte nga më çnjerëzoret dhe të rënda me të cilën detyroheshin të pranonin fajin edhe në rastet kur i pandehuri nuk ka qenë kryerës i veprës penale. Ekzistimi i burgjeve llogaritet të ketë ekzistuar prej kohëve më të vjetra, faktikisht prej krijimit të shteteve. Burime historike tregojnë se ndër shtetet e para që njohin dënimin me burg janë: Egjipti i vjetër, Mesopotamia, Asiria, Babilonia, Roma, Greqia e vjetër, ku si burgje janë llogaritur kështjellat, bodrumet, kishat e caktuara, e tjera. Mirëpo dallimi i burgjeve të hershme dallon prej burgjeve të sotme për nga kushtet që në atë kohë kanë qenë tepër të rënda dhe të mjerueshme, por dallohen edhe për nga kohëzgjatja e mbajtjes së burgut për shkak se burgjet e atëhershme shërbenin për një periudhë të caktuar me çka sigurohej prezenca e të pandehurit deri në vendimin e dënimit dhe pastaj pasonte dënimi me vrasje apo me lëndime trupore. Pra ky lloj burgimi me sistemin tonë bashkëkohor mund të krahasohet me paraburgimin. Sistemi i

---

<sup>1</sup> Gashi, Rexhep, Ekzekutimi i dënimit me burg në Shqipëri, Prishtinë 2001, faqe 9, 10, 11.

ndëshkimit gjatë kohës së vjetër dhe të mesme ishte tepër i rëndë dhe i vrazhdë dhe johuman e që në praktik nuk dha rezultate të nevojshme për pengimin e kriminalitetit , nëpërmjet filozofëve, autorëve, shkollave të para paraqiten idetë për një lloj sanksioni të ri i cili do të zëvendësoi dënimet e rënda e që do të ishte izolimi i personave të dënuar dhe angazhimi i tyre në punë. Dhe në drejtim pozitiv drejt humanizmit në sistemin bashkëkohor në fund të shekullit XVIII dhe fillim të shekullit XIX paraqitet dënimi me burgim me qëllim të pengimit të kriminalitetit dhe përmirësimin e gjendjes të dënuarve. Dënimi me burg si lloj i veçantë i sanksioneve penale paraqitet në fund të shekullit XVIII dhe fillim të shekullit XIX, ku për herë të parë është paraparë në Kodin Penal të Francës të vitit 1791, pastaj më vonë edhe në kodet tjera evropiane dhe të SHBA-së. Shkaqet e paraqitjes së këtij lloji të veçantë ishte aspekti humanizmit që të bëhen ndryshime në vend të vrasjeve dhe torturave fizike, nevoja e krahut të punës me çka të dënuarit në vend që të vriteshin ato shfrytëzoheshin si fuqi punëtore nga klasa borgjeze, përparimi i shteteve, urbanizmi, teknologjia, idetë e shkollave të ndryshme e gjithashtu edhe të filozofëve ndikuan në përmirësimin dhe avansimin e dënimit me burg. Gjatë shekullit XIX shihet një pluralizëm i llojeve të dënimit me burgim apo të heqjes së lirisë duke filluar nga Kodi i Napolonit 1810 ku për veç burgimit kemi edhe internim, deportacion, relegacion, detyrim në punë të dhunshme, ku forma të ngjajshme shihen edhe në disa shtete të Evropës.<sup>2</sup> Këto dënime ishin të rënda dhe kushtet në të cilat mbaheshin ishin tepër të vështira, jonjerëzore me kushte të mjerueshme duke pasur rrezik të madh në përhapjen e sëmundjeve të rënda ngjitëse siç ishin epidemi të ndryshme , kolera , e tjera, e që ishin shkak për vdekjen e mijëra të burgosurve. Si burgje të para kanë qenë bodrumet e caktuara , kështjellat, objektet fetare, manastiret. Për shkak se me këto forma të burgjeve nuk arrihej aspak qëllimi i përmirësimit dhe risocializimit të dënuarve, u paraqitën idetë e para nga shkollat humaniste, pozitiviste italiane dhe ato sociologjike që të lihet anash kjo formë e dënimit që paraqiste vetëm shpëtim dhe hakmarrje ndaj kryerësit por të shikohet risocializimi dhe përmirësimi i tij<sup>3</sup>. Kjo ide filloj të adaptohet dhe aplikohet edhe sot e kësaj dite që kemi si dënim më të shpeshtë dënimin me burg dhe ndahet në dënim me burg të rëndë dhe dënim me burg të përhershëm. Në kohën bashkëkohore shkohet drejt alternativave të transformimit të dënimit me burgim ku shtetet më të zhvilluara si

---

<sup>2</sup> Gashi.Rexhep,Ekzekutimi i dënimit me burg në Shqipëri,Prishtinë 2001,faqe 9,10,11.

<sup>3</sup> Halili.Ragip,Penologjia,Prishtinë 2010,faqe 102.

forma të heqjes së lirisë kanë gjysmë lirinë, burgun shtëpiak, angazhim në punë të caktuar dhe puna në dobi të përgjithshme.

**Gjysmë liria** llogaritet kur personi për një kohë të caktuar është në burg, brenda ditës disa orë është në liri për të kryer nevojat apo aktivitetet në punë dhe natën kthehet në burg apo forma tjetër kur burgun e kryen gjatë vikendit.

**Burgu shtëpiak** është atëher kur vuajtjen e dënimit nuk e mbajnë në burgje apo ente përkatëse por të njejtën e mbajnë në hapsirat shtëpiake për shkaqe të ndryshme, këto raste u jepet personave të moshuar apo personave që për shkaqe shëndetësore nuk mund të qëndrojnë në burg. Ky lloj dënimi në shtetet më të zhvilluara jepet edhe për të miturit dhe kontrolli i respektimit të këtij dënimi bëhet me mjete moderne të sofistikuar.

**Puna në dobi të përgjithshme** gjithashtu është e aplikueshme edhe në sistemin bashkëkohor mirëpo ajo njihet edhe në kohërat e vjetra ku ka qenë më e zbatueshme që nga vet fakti dihet se në Maqedoni gjatë sundimit të Turqisë personat e dënuar janë shfrytëzuar për punë të dobishme në formë të dhunshme duke i detyruar edhe të largohen nga vendi që të dërgohen në vendet e caktuara sipas nevojës të shtetit sundues<sup>4</sup>. Këto forma të dënimit i aplikojnë shtetet e zhvilluara si Zvicra, Gjermania, Suedia, Danimarka, Holanda, e tjera.

---

<sup>4</sup> Kambovski.Vlado, E Drejta Penale,2007,Shkup,faqe470.

## SISTEMET E BURGUT

### A) Sistemi i burgut kolektiv

Llogaritet si sistemi më i vjetër i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe ka ekzistuar që nga paraqitja e burgjeve të para e deri në kohën e zhvillimit gjegjësisht transformimit të burgjeve. Si vende në të cilat është mbajtur dënimi kanë qenë bodrumet, kështjellat, kazernat ku kushtet ishin mjaft të rënda, kurse më vonë edhe ndërtesat e posaçme.

Sipas këtij sistemi dënimi është mbajtur bashkërisht apo në mënyrë kolektive, pra ka ekzistuar vetëm izolimi nga bota e jashtme kurse brenda nuk ka ekzistuar asnjëfarë lloji klasifikimi por dënimet i mbanin bashkërisht personat e dënuar për krimet e rënda bashkë me ato të krimeve të lehta, personat madhor bashkë me ato të mitur, recidivistët bashkë me primarët, me çka këto vende më nuk ishin qendra për përmirësim por ato ishin qendra dhe vatra të kriminalitetit dhe përhapjen e sëmundjeve të rënda ngjitëse. Shumë autor këto burgje i quanin si *“universitete të krimet”*.<sup>5</sup> Ky lloj i burgut edhe pse u llogarit si pozitiv për dallim nga burgjet e më hershme nga mangësitë dhe të metat që kishte u kritikua nga shumë autor siç ishin Xhon Hauard, Mirabo dhe Xhem Bentam.

### B) Sistemi i qelisë apo izolimit

Si shkas i sistemit kolektiv lind ideja për krijim e këtij sistemi, ku i dënuari për dallim nga sistemi kolektiv do të jetë larg ngjitjes sëmundjes ashtuquajtur *“sëmundjes kriminalitetit”*. Është sistemi i parë i rregulluar në mënyrë normative juridike dhe ndryshe quhet edhe si sistemi Pensilvanik nga që emrin e ka marrë sepse për herë të parë paraqitet në SHBA në vitin 1790 në Filadelfia të Pensilvanisë. Këtë sistem e përkrahin besimtarët e një sekti fetar krishterë *“kueker”*<sup>6</sup> të cilët ishin kundër vrasjes dhe torturës, duke menduar se personi apo kryerësi vetëm në mënyrë të izoluar dhe i vetmuar mund të pendohet dhe përmirësohet për krimet e

---

<sup>5</sup> Halili.Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2010, faqe 102.

<sup>6</sup> Po aty.

bëra, duke vuajtur në gjendje shpirtërore dhe morale i vetëm në një qeli për një kohë të caktuar.<sup>7</sup> Ekzistojnë dy variante të këtij dënimi ai klasik i qelisë dhe i heshtjes apo Obernit.<sup>8</sup>

### 1. *Sistemi klasik*

Ky sistem paraqitet në vitin 1818 në SHBA në shtetin e Pensilvanisë ku sipas këtij sistemi çdo i dënuar është i vendosur në qeli të veçantë i vetmuar duke e izoluar dhe duke mos pasur kontakt me persona apo të burgosur tjerë. Kontakti ka qenë i mundshëm vetëm me personelin e burgut kohë pas kohe dhe me udhëheqësin fetar apo priftin pasi kanë qenë të detyruar në mbajtjen e ritualeve fetare. Arritja e përmirësimit dhe pendimit tij është lidhur me besimin fetar me çka është lejuar shfrytëzimi i librave fetare.

### 2. *Sistemi i obernit apo heshtjes*

Pas përpjekjeve që u bënë për reformimin e sistemit të qelisë në qytetin e Obernit të Nju Jorkut ku edhe mori emrin ky sistem, u arrit një lloj kombinimi i sistemit të qelisë dhe burgut kolektiv. Për këtë sistem është karakteristik se të dënuarit natën qëndrojnë të ndarë apo të izoluar kurse gjatë ditës qëndrojnë bashkë duke i detyruar të punojnë por të qëndrojnë të heshtur. Pra komunikimi dhe bisedat në mes tyre ishin rreptësisht të ndaluara dhe thyerja e kësaj rregulle të heshtjes është dënuar mjaft rëndë. Përparësi e këtij sistemi ka qenë se u është dhënë mundësia të punojnë dhe të jenë aktiv e jo si në sistemin e qelisë të qëndrojnë të mbyllur. Kurse mangësia ka qenë detyrimi për të heshtur dhe dënimet rigoroze dhe të rënda që janë dhënë për shkelje të saj.

### C) *Sistemi progresiv*

Në këtë sistem shihet qartë kthimi ka personaliteti i kryerësit ku i dënuari gjatë kohës në burg mund të kalon disa faza me çka arrihet progres në përmirësimin e tij duke ndryshuar pozitën. Në fillim vendoset në burgun e qelisë, nëse ka shenja se ka ndryshuar dhe përmirësuar sjellja e tij pozitivisht kalon në burgun kolektiv ku angazhohet në punë dhe pastaj nëse me angazhimin e tij tregon përparim dhe arritje të qëllimit edukativ pozitiv dhe nëse jepet vërejtja

---

<sup>7</sup> Halili.Ragip, Penologjia, Prishtinë, 2010, faqe 105, 106.

<sup>8</sup> Po aty, faqe 105.

nga personeli se është arritur ky qëllim mund të vij deri te faza e favorshme që është lirimi me kusht. Pra lëvizja nëpër këto faza në mënyrë progresive paraqet këtë sistem. Paraqitja e këtij lloji ishte në Australi pastaj në Irlandë më vonë edhe në disa shtete tjera të Evropës.

*D) Sistemi bashkëkohorë apo sistemi modern*

Sistemi bashkëkohorë i dënimit me burg që zbatohet në praktikën e shteteve bashkëkohore bazohet apo ka për qëllim kryesorë riedukimin dhe risocializimin e kryerësit të veprës penale gjegjësisht të dënuarit për dallim nga e kaluara kjo ide nuk ekzistonte por qëllimi i vetëm ka qenë ndëshkimi dhe hakmarrja ndaj kryerësit të veprës penale. Nga sistemet e mëparshme sistemi bashkëkohor është shumë më i përshtatshëm dhe më adekuat edhe pse gjithmonë ekzistojnë dhe ka tendenca për përmirësimin dhe zhvillim e kushteve. Kushtet e të dënuarve brenda institucioneve tentohet të jenë sa më të përafërta me ato të njerëzve në liri, normalisht se ato dallojnë prej shtetit në shtet duke marrë parasysh zhvillim ekonomik të vet shtetit. Qëllimi i këtij sistemi është që të arrihet vetëdijësimi dhe risocializimi apo riedukimi i të dënuarit që të jetë i gatshëm për jetën në liri, pra të mos bëhet shkatërrimi i jetës shpirtërore , profesionale dhe integriteti personal për dallim nga sistemet e më hershme.

Edhe në këtë sistem ekzistojnë disa faza edhe atë:

- 1. Faza e parë sipas sistemit bashkëkohor është faza e observimit dhe studimin e personave të dënuar.*
- 2. Faza e dytë e sistemit bashkëkohorë apo modern është faza e klasifikimit të gjerë dhe individualizim i personave të dënuar.*
- 3. Faza e tretë sipas këtij sistemi është lëshimi me kusht dhe ndihma post penale të personave të dënuar<sup>9</sup>*

---

<sup>9</sup> Halili.Ragip, Penologjia, 2010 Prishtinë, shih faqe 120.

## 2. PËRKUFIZIMI I DËNIMIT ME BURG

Nëpërmjet dënimit me burg sistemi juridik i një shteti arrinë që të rregullon sjelljet e caktuara shoqërore, me të cilat sjellje nuk respektohen dhe shkelen normat juridike dhe ligjore nga kryerësit e veprave penale, atëherë shkelësit e normave ndëshkohen dhe të njejtit dënohen dhe ndalohen me burgim apo heqje nga liria.

*“dënimi është kthim i drejtësisë për veprën e kryer, në fakt e keqe e paramenduar dhe e qëllimshme që i shkaktohet kryerësit për veprën e kryer dhe në kornizën e fajësisë së veprës”<sup>10</sup>.*

Nga definicioni i lartpërmendur kuptojmë se dënimi është sanksion juridik i rregulluar me ligj nga sistemi juridik shtetëror me qëllim të vënies së një rendi brenda shoqërisë, respektimit të parimeve themelore dhe esenciale për ruajtjen e drejtësisë. Dënimi llogaritet si një e keqe e paramenduar që i shkaktohet kryerësit të veprës penale me qëllim apo si këmbim ndaj të keqes që ka shkaktuar por jo si e keqe e qëllimshme. Si lloj më i rëndë në mesin e dënimeve të veprave penale, dënimi me burg është i rregulluar dhe paraparë në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë në nenin 35 kodit penal, ku dënim me burgim nënkuptojmë heqjen e lirisë kryerësit të veprës penale penalisht të përgjegjshëm në formë të dhunshme në procedurë të caktuar gjyqësore.

Si elemente kryesore për shqiptimin e dënimit me burgim llogariten:

- Dënimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, duke respektuar parimin e ligjshmërisë. ***Nullem poena sine lege***- që do të thotë nuk mund të caktohet dënim nëse i njëjti nuk është i paraparë me ligj.
- Dënimi me burg duhet të jetë i natyrës personale, pasoja të godasin vetëm kryerësin e veprës penale.
- Dënimi me burg duhet të jetë human, duke ruajtur integritetin fizik dhe psikik të dënuarit që nënkuptojmë se i hiqen dhe kufizohen vetëm të drejtat e përcaktuara me ligj.

---

<sup>10</sup> Kambovski.Vllado, E drejta penale, shih faqe 441.

- Dënimin e shqipton organi shtetëror, gjykata në procedurë të rregullt ligjore.
- Dënimi me burg duhet të jetë proporcional me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë shoqërore të kryerësit të veprës penale.
- Dënimi duhet t'i godas njëloj kryerësit e veprave penale duke mos marrë parasysh përkatësin nacionale, fetare, politike, racore, sociale .
- Dënimi nuk guxon të konsiderohet si torturë, vuajtje dhe nënshtrim i të dënuarit e as në rënien e integritetit moral dhe fizik.
- Dënimi duhet të jetë i përmirësueshëm, si rezultat i mundësisë së shqiptimit të kundërligjshëm të dënimit.
- Dënimi duhet të jetë i revokueshëm, si rezultat i gabimeve dhe lajthitjeve gjyqësore dënimi mund të anulohet.
- Dënimi duhet të jetë i zëvendësueshëm, ku në të gjitha rastet e arsyeshme mund të zëvendësohet me dënim tjetër me qëllim të arritjes suksesit të dëshiruar.
- Dënimi duhet të jetë i individualizuar, që dënimi duhet t'i përshtatet personalitetit dhe vetive fizike dhe psiqike të dënuarve.
- Dënimi duhet të jetë i moralshëm, duhet të ngrit ndërgjegjen e kryerësit të veprës penale për shkeljen e vlerave morale dhe juridike dhe respektimin e tyre në të ardhmen.

Qartë shihet në nenin 38 të ligjit për ekzekutimin e sanksioneve të Republikës së Maqedonisë se personalitetit apo dinjitetit dhe integritetit të kryerësit të vepër penale i jepet rëndësi për respektimin e të drejtave themelore.

*(1) gjatë ekzekutimit të dënimit me burg doemos duhet të mbrohet integriteti psikofizik dhe moral i personit të dënuar dhe të respektohet personaliteti dhe dinjiteti njerëzor.*

*(2) ndalohet çdo formë e mundimit, sjelljes jonjerëzore apo sjellje fyese ndaj të dënuarit.*



*(3) doemos duhet te sigurohet e drejta e sigurisë personale e personit të dënuar dhe vetë respektimi i personalitetit të tij<sup>11</sup>.*

Këto të drejta themelore që i përkasin të dënuarit si mbrojtja e integritetit moral dhe psikofizik dhe respektimi i dinjitetit dhe personalitetit janë të rregulluara dhe të paraparë si në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë, në sistemin vendor ashtu edhe me konventa ndërkombëtare ku me 6 Prill të vitit 1992 komiteti për të drejtat e njeriut pranë OKB-së shpalli që shtetet të respektojnë integritetin moral dhe psikofizik të dënuarve me burg. Sipas saj këto janë të drejta fundamentale dhe patjetër të respektohen të dënuarit me burg në mënyrë njerëzore nga shtetet. Në mënyrë decide në dokumentet ndërkombëtare janë ndaluar të gjitha format e mundimit dhe torturat e ndryshme ndaj të dënuarit. Respektimi i këtyre të drejtave lidhet ngushtë me parimin e humanitetit. Ky parim ka rëndësi të veçantë në praktikën bashkëkohore që nënkuptojmë trajtim dhe sjellje njerëzore ndaj të dënuarit. Ky parim nisët nga ideja se kryerësi i veprës penale edhe pse ka gabuar i njejtë nuk është zhveshur nga subjektiviteti njerëzor dhe duhet respektuar personalitetin dhe dinjitetin e tij, kurse për veprën kriminale atij i është shqiptuar sanksioni. Ky parim vjen në shprehje edhe më shumë pasi që sistemi bashkëkohor si qëllim kryesorë nuk është hakmarrja dhe shpagimi por risocializimi dhe integrimin e të dënuarit, pra kuptimi i qëllimit është që edhe pas vuajtjes së dënimit kryerësi të rikthehet në shoqëri, e kjo arrihet me të vetmin mënyrë që është sjellja humane dhe respektimi i vlerave elementare njerëzore. Respektimi i këtyre vlerave në mënyrë decide është i paraparë dhe rregulluar me kushtetutë, ligje, akte ndërkombëtare. Të gjitha sjelljet që mund të kryhen mbi të dënuarin shtrëngimet dhe kufizimet janë në raste të jashtëzakonshme përsëri duke respektuar parimet themelore. Në praktikën e disa shteteve policore jodemokratike fatkeqësisht këto parime shkelen dhe ndaj të dënuarve ushtrohen tortura të ndryshme duke cenuar integritetin moral dhe personal me çka efikasiteti i risocializimit dhe riedukimit rëndë e ndoshta fare nuk arrihet.

---

<sup>11</sup> Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve në Republikën e Maqedonisë, neni 38.

### 3. QËLLIMI I DËNIMIT ME BURG SIPAS KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Si në të gjitha sistemet penitensiare bashkëkohore ashtu edhe në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë qëllimi i dënimit me burg apo heqje të lirisë është larg idesë së ndëshkimit dhe hakmarrjes ndaj kryerësit dhe pikërisht atë e parasheh në mënyrë decide dhe qëllimin e dënimit me burg në kodin penal të RM-së ku kemi nenin 32 si vijon<sup>12</sup>:

- 1) *pengimi i kryerësit të kryej veprë penale dhe riedukimi i tij , dhe*
- 2) *në mënyrë edukative të ndikoj ndaj të tjerëve të mos kryejnë vepra penale.*

Prej këtu kuptojm se në radhë të parë si qëllim kryesorë është realizimi i drejtësisë si parim kryesor dhe fundamental, mbrojtja e lirive dhe të drejtave themelore dhe mbrojtja e shoqërisë nga krimet dhe veprat penale. Sipas KPM-së si qëllime kryesore të dënimit me burg apo heqjes të lirisë nënkuptojmë apo kemi preventivën speciale, preventivën gjenerale dhe realizimi i drejtësisë.<sup>13</sup> Preventiva speciale lidhet me kryerësin delikuent i cili ka kryer veprë penale dhe qëllimi i saj është që i njëjti të pengohet në vazhdimin apo kryerjen e ndonjë veprë tjetër penale dhe qëllimin që i njëjti duhet t'i nënshtrohet procesit të risocializimit apo riedukimit që të përsoset, edukohet dhe bindet për veprat e kryera me qëllim të vazhdimin të jetës normale. Pengimi i delikuentit realizohet duke e frikësuar për sjelljet e tij që në të ardhmen mos jetë pjesë e shkelësve të ligjit apo rregullave , nëpërmjet izolimit duke e neutralizuar me çka arrihet distancimi i tij nga krimet e mundshme dhe mbrojtja e caktuar e shoqërisë apo individëve nga kriminaliteti.

Risocializimi apo riedukimi është qëllim kryesorë i KPM-së pasi ajo respekton parimet themelore dhe idenë se heqja e lirisë personit caktuar nuk paraqet ndëshkim e as hakmarrje për veprën e kryer por vetëm pendim , edukim dhe adaptim të dënuarit që arrihet me anë të procesit të risocializimit. Me procesin e risocializimit personi i dënuar gjatë qëndrimit në entin përkatës aftësohet, përmirësohet, edukohet që të ngrit vetëdijen personale dhe të jetë në gjendje dhe i gatshëm për respektimin e normave shoqërore, gjegjësisht rregullave normative dhe pavarësinë e kthimit në bashkësinë shoqërore si qytetar i rëndomtë dhe të jetë në gjendje

---

<sup>12</sup> Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, neni 32.

<sup>13</sup> Po aty.

që vet të siguroj ekzistencën duke punuar ndershmerisht. Pasi delikuenti ka kryer veprën penale dhe ka shkelur rregullat normative me sjelljet e tij kriminale, atëherë nëpërmjet procesit të riedukimit në ent apo në organin përkatës mundohet të arrihet bindja dhe edukimi me qëllim të respektimit të normave dhe rregullave shoqërore që në të ardhmen mos t'i shkel të njejtat. Praktika e deritanishme tregon edhe të kundërtën apo mos arritjen e këtij procesi të risocializimit ndaj të dënuarve nga natyra komplekse e këtij fenomeni ku si rezultat kemi paraqitjen e recidivizmit, ku me recidivizëm nënkuptojmë se vepra penale është kryer nga delikuent veç më i dënuar më parë për vepër tjetër penale gjegjësisht përsëritjen e veprës penale nga i njëjti person. Preventiva gjenerale përveç dënimit ndaj kryerësit qëllimi i saj është frikësimin apo edukimin e të tjerëve përkatësisht delikuentët potencial për të mos kryer vepra penale. Nga vet ekzistimi i kodit penal sigurohet sanksionimi i kryerësit, përndjekja efikase dhe ekzekutimit të dënimit me çka arrihet qëllimi i frikësimit dhe ndikimi edukativ-moral. Mbjellja e frikës në publikun e gjërë arrihet me vet sanksionimin që të gjithë qytetarët apo delikuentet potencial t'i zbrapsen kryerjes të veprave penale të mundshme pasi edhe ato mund t'i gjejë një e keqe që ka gjetur të dënuarin, pra arrihet frikësimi kolektiv. Përveç qëllimit të frikësimit, me anë të preventivës gjenerale synim tjetër është edhe ndikimi edukues, ngritjen dhe përforcimin e moralit që do të arrij deri te garantimi për respektimin e rregullave normative dhe stabilitetin në rrethin shoqëror.

Qëllimi i dënimit me burg në RM-së është i rregulluar edhe me ligjin për ekzekutimin e sanksioneve me nenin 37 si vijon<sup>14</sup>;

- 1) *Qëllimi i ekzekutimit të dënimit me burg është aftësim i personave të gjykuar që të kyçen në shoqëri me gjasa më të mira për jetë të pavarur në pajtim me ligjin.*
- 2) *Për shkak të arritjes së qëllimit të ekzekutimit të dënimit me burg te personat e dënuar zhvillohet ndjenja e përgjegjësisë dhe nxiten që ta pranojnë dhe në mënyrë aktive të marrin pjesë në trajtim gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, të motivuar dhe të drejtuar në riedukim dhe zhvillim të cilësive pozitive të karakterit dhe aftësive që shpejtojnë kthimin e suksesshëm në shoqëri.*

---

<sup>14</sup> Osmani.Afrim, Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, Shkup 2013.

Për realizimin e qëllimeve të dënimit sipas kodit penal të RM-së janë matja gjyqësore e dënimit duke e bazuar të njëjtin mbi parimet e individualizimit dhe ligjshmërisë, vuajtjen e dënimit dhe ndihmën postpenale që i jepet të dënuarit pas vuajtjes së dënimit.

#### **4. DËNIMI ME BURG SIPAS KODIT PENAL TË MAQEDONISË**

Me dënimin me burg kuptojmë heqjen e lirisë në mënyrë të dhunshme kryerësit penalisht të përgjegjshëm nga ana e gjykatës në procedurë të rregullt gjyqësore dhe në afat kohor të caktuar. Edhe në sistemin tonë dhe praktikën gjyqësore bëhen përpjekje për kufizimin, përmirësimin dhe avansimin e këtij dënimi që të arrihet arsyeshmëria e shkallës më të lart nga shkak i kompleksitetit apo rëndësisë të këtij dënimi. Duke u nisur nga respektimi i parimit të humanizmit për dënimin me burg dhe afrimin me idetë dhe praktikën e shteteve bashkëkohore evropiane, sistemi jonë këtij lloji dënimi e rregullon në mënyrë ligjore në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë. Teoria e shumë shteteve se dënimi me kohëzgjatje të shkurtër nuk është i dëshiruar dhe jo i dobishëm pasi me të nuk arrihet qëllimi kryesorë procesi i risocializimit dhe riedukimit të kryerësit për shkak të kohës e cila nuk është e mjaftueshme, edhe sistemi i Republikës së Maqedonisë është përkrahëse kësaj ideje dhe e praktikon në legjislacionin dhe praktikën gjyqësore<sup>15</sup>. Në krahasim me disa sisteme që parashohin dënim edhe prej një dite që nuk është e preferuar në sistemin tonë, ku kjo çështje është e rregulluar me kodin penal të Republikës së Maqedonisë në nenin 35, ku thuhet se dënimi me burg nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë.

Sipas kodit penal të Republikës së Maqedonisë dënimet ndahen në dënime primare dhe dënime sekondare.<sup>16</sup> Dënimet primare janë dënimi me burgim dhe dënimi me të holla, kurse si dënime sekondare janë ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë dhe detyrës, ndalimi i drejtimit të automjetit dhe dëbimi i të huajt nga vendi. Dënimi me burg apo heqjes lirisë bën pjesë në dënimet kryesore bashkë me dënimin me të holla. Dënimi me burg mund të

---

<sup>15</sup> Kambovski.Vlado, E drejta penale, Shkup, 2007, shih faqe 478.

<sup>16</sup> Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, neni 35.

shqiptohet vetëm si dënim kryesorë apo primar për dallim nga dënimi me të holla që mund të shqiptohet edhe si dënim primar edhe sekondar kur shqiptohet bashkë me dënimin me burg.

Në nenin 35 të Kodit Penal të RM-së janë të parapara dhe të rregulluara të gjitha format ligjore dhe afatet kohore të këtij dënimi. Për sa i përket afatit apo kohëzgjatjes së këtij dënimi kemi minimumin dhe maksimumin ku sipas nenit 35 paragrafi 1 të KPM-së dallojmë burg të kufizuar, burg afatgjatë dhe burg të përjetshëm. Minimumi ligjor i dënimit është 30 ditë kurse maksimumi deri 20 vjet, për veprat e rënda penale që është paraparë dënim me burg të përjetshëm mund të shqiptohet dënim me burg prej 40 vjetëve, derisa për veprat e kryera me dashje është paraparë dënim deri 20 vjet për format e rënda dhe të paramenduara të asaj veprave mund të caktohet edhe burgim i përjetshëm. Dënimi me burg të përjetshëm për herë të parë në legjislacionin tonë të Maqedonisë paraqitet në vitin 1996 si zëvendësim nga heqja dënimit me vdekje dhe plotësimin e zbrasëtirës juridike. Ky dënim nuk mund të caktohet si dënim i vetëm kryesorë, që del se mund të shqiptohet si dënim alternativ bashkë me dënimin kryesorë që është dënim me burg deri 20 vjet si dhe ai deri në 40 vjet burg i rregulluar me nenin 35 të KPM-së. Duke respektuar dhe mbrojtur parimet themelore ligji në mënyrë të qartë cakton se dënimi me burg të përjetshëm nuk mund t'i shqiptohet personave apo kryerësve të veprave penale të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i kanë mbushur 21 vjet. Pra në këtë rast gjyqi lirisht mund të zgjedh dënim qoftë edhe mbi maksimumin ligjor që është 20 vjet por asesi burg të përjetshëm. Edhe pse personi 21 vjeçar ka kaluar adoleshencën përsëri llogaritet si madhor i ri dhe përgjegjësia e tij për rastet e rënda është diskutabile. Dënimi me burg shqiptohet në vite dhe muaj të plotë, kurse dënimet më të lehta që mund të jenë deri në gjashtë muaj edhe në ditë të plota,(n.35.p.6.KPM)<sup>17</sup>. Kur maksimumi i dënimit nuk është më i lartë se 3 vite ndërsa minimumi nuk është caktuar atëherë bashkë me dënimin me burg shqiptohet edhe dënimi me të holla. Dënimi me burg shqiptohet nga gjykata në procedurë të rregullt ligjore dhe pas respektimit të afateve ky dënim vihet në institucionet përkatëse për vuajtjen e dënimit të përcaktuar me ligj.(neni 35.p.7 KPM)<sup>18</sup>. Institucionet për vuajtjen e dënimit ndahen në dy lloje, të hapura dhe të mbyllura. Për respektimin e lirive dhe të drejtave

---

<sup>17</sup> Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë neni 35.

<sup>18</sup> Po aty, neni 35.

të dënuarve, Republika e Maqedonisë në vitin 1997 në sistemin e saj juridik përfshin edhe standardet ndërkombëtare si ato të OKB-së që janë “rregullat standarde minimale për sjellje me të burgosur” si dhe rregullat evropiane të burgut nga Komiteti i Ministrave të KE-së nga viti 1982. Klasifikimi i të dënuarve në institucionet përkatëse shtetërore bëhet sipas gjinisë, moshës, kohëzgjatjes së dënimit dhe nevojës së sigurisë nga largimi për mundësin e ikjes të dënuarve.

## II- KAPITULLI I DYTË

### VËSHTRIME KRAHASUESE TË DËNIMIT ME BURGIM NË DISA KODE PENALE TË RAJONIT DHE MË GJËRË.

Në këtë kapitull do të paraqesim rregullimin dhe përcaktimin ligjor të dënimit me burg në sistemet juridike të shteteve të rajonit dhe më gjërë, si atë të Kosovës, Shqipërisë, Kroacisë, Sërbisë dhe Malit të Zi. Formën dhe mënyrën se si e rregullojnë ato dënimin me burg, krahasimin e tyre duke gjetur dallimet dhe ngjajshmëritë ligjore në mes tyre dhe sistemit tonë apo konkretisht Kodit Penal të Maqedonisë, ky përshkrim do të bëhet me ndihmën e metodës krahasuese.

#### 1. DËNIMI ME BURG NË KODIN PENAL TË KOSOVËS

Sipas kodit penal të Kosovës në nenin 43 janë përcaktuar dënimet kryesore, e që janë: dënimi me burg të përjetshëm, dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë. Dënimin me burg të përjetshëm kodi penal i Kosovës e përcakton në nenin 44 ku qartë shihet se ligji parasheh këtë formë të dënimit për veprat më të rënda penale, të kryera në rrethana veçanërisht rrënduese ose për vepra penale që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda.<sup>19</sup> Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund të parashihet si dënim kryesorë dhe i vetëm për një vepër të veçantë penale, me çka ky dënim çdo herë parashikohet në mënyrë alternative me dënimin me burg. Ky dënim nuk mund të shqiptohet në rastet kur kryerësi i veprës penale në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur 21 vjet dhe në rastet kur kryerësi në kohën e kryerjes së veprës penale ka pësuar aftësi esencialisht të zvogëluar mendore. Dënimi me burgim në kodin penal të Kosovës është i rregulluar në nenin 45 , gjithashtu edhe ky dënim është dënim kryesorë. Për sa i përket kohëzgjatjes së këtij dënimi sipas KPK së kemi të rregulluar minimumin dhe maksimumin kohor. Gjersa minimumi nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e as maksimumi nuk mund të jetë më i gjatë se 25 vjet.(neni 45,parag.1)<sup>20</sup> . Dënimi me burg shqiptohet në muaj dhe vite të

<sup>19</sup>Kodi Penal i Kosovës,nr04/L-82,2013,neni 43,44.

<sup>20</sup> Po aty,neni 45.

plota, e në rastet kur dënimi është caktuar deri në 6 (gjashtë) muaj , dënimi shqiptohet edhe në ditë të plota.

Dallimet e dënimit me burg në mes kodit penal të Kosovës dhe atij të Maqedonisë janë shumë të vogla pothuajse nuk ekzistojnë fare, pasi që shihet ngjajshmëri në të gjitha përcaktimet ligjore duke u nisur nga ndarja e këtij dënimi, minimumi dhe maksimumin e përcaktimit ligjor , shkallën e përgjegjësisë personale, e tjera. Dallimi i vetëm shihet në lartësinë e shqiptimit të dënimit me burg, pra maksimumin që sipas KPM-së është 20 vjet e për veprat e rënda apo me dashje edhe deri 40 vjet , kurse sipas KPK-së maksimumi i dënimit me burg është 25 vjet.

## **2. DËNIMI ME BURG NË KODIN PENAL TË SHQIPËRISË**

Në të drejtën penale shqiptare dënimet kryesore paraqesin dënimet më të rënda penale që mund të shqiptohet ndaj kryerësve të veprave penale. Sipas nenit 29<sup>21</sup> KPSH-së dënimet kryesore janë të përcaktuara në mënyrë taksative: dënim me burgim të përjetshëm, dënim me burgim dhe dënim me gjobë. Dënimi me burgim të përjetshëm si sanksion më i rëndë shqiptohet për kryerësit e krimeve të rënda (neni 31), gjegjësisht kur vepra është kryer me dashje dhe në forma dhe rrethana veçanërisht të rënda. Ky vendim jepet me vendim të gjykatës ndaj kryerësit për veprën e rëndë penale me çka konsiston në marjen e lirisë së lëvizjes dhe qarkullimit për tërë jetën. Nga shkak se është dënim kryesorë dënimi me burgim të përjetshëm mund të përcaktohet si dënim i pavarur në krahasim me dënimet tjera. Sipas nenit 31 paragrafit 2<sup>22</sup> në mënyrë decide parashihet se dënimi me burg të përjetshëm nuk mund të shqiptohet ndaj personave që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur moshën prej 18 vjeç dhe personave të gjinisë femërore, konkretisht grave. KPSH-së dënimin me burgim si lloj i dytë i dënimeve kryesore për krimet e rënda e përcakton në nenin 32,<sup>23</sup> ku dënimi me burg për krime jepet për një kohë nga 5 ditë që nënkuptojnë se minimumi i shqiptimit të

---

<sup>21</sup> Kodi Penal i Shqipërisë, 2011 shtatorë, neni 29.

<sup>22</sup> Po aty, neni 31.

<sup>23</sup> Po aty, neni 32.



dënimit është 5 ditë kurse maksimumi i lartësisë së dënimit që mund të shqiptohet është 25 vjet. Mënyra e vuajtjes së dënimit me burg të përjetshëm dhe dënimit me burg në KPSH-së është e rregulluar dhe paraparë në nenin 33<sup>24</sup>, ku këto dënime sipas kësaj dispozite ruhen në institucione përkatëse shtetërore, gjersa me ligj caktohen rregullat mbi mënyrën e vuajtjes së dënimit, të drejtat dhe detyrat e të dënuarve. Të miturit, vuajtjen e dënimit e mbajnë në vende dhe hapsira të veçanta dhe të ndara nga vendet ku qëndrojnë personat e rritur apo madhor, gjithashtu edhe gratë dënimin e vuajnë në institucione përkatëse të ndara nga burrat.

Nëse bëjmë krahasim në mes KPSH-së dhe KPM-së do të vërejmë ngjajshmëritë dhe dallimet në mes tyre. Duke filluar nga dënimi me burgim të përjetshëm ku përcaktimi dhe forma e dhënies janë të njejta gjersa dallimi është në moshën e kryerësit që shqiptohet ky dënim pasi në Shqipëri apo legjislacionin e tyre nuk u jepet personave që në kohën e kryerjes nuk kanë mbushur moshën 18 vjeçare, e që në KPM-së mosha e caktuar për dhënien e këtij dënimi është 21 vjet. Mosha 18 vjeçare edhe pse llogaritet se personi është madhor përsëri përgjegjësia e plotë e tij mund të mos jetë arritur dhe shumë shtete këtë e kanë marrë me rezervë dhe kanë lejuar që kjo kategori të llogaritet apo të ketë lëshime lehtësuese deri në moshën 21 vjeçare, duke u nisur nga kjo ide edhe sistemi jonë juridik ka përparësi sepse parasheh këtë lloj dënimi duke e konsideruar të mundshëm për personat prej moshës 21 vjeçare e më tepër. Si dallim tjetër, e që është përparësi e KPSH-së është se përcakton se dënimi me burg të përjetshëm nuk mund tu jepet grave, nga konsiderata për gjininë femërore që llogaritet se ato nuk mund të kryejnë vepra të rënda, edhe pse praktika tregon të kundërtën. Dallim tjetër mund të shihet edhe në dënimin me burgim ku sipas KPSH-së ky dënim mund të jepet prej 5 ditësh apo minimumi mund të jetë 5 ditë e që nënkuptojmë dënim afatshkurtër e nga ana tjetër kemi thënë se kjo formë e dënimit nuk është efikase, kurse KPM-së si minimum ka 30 ditë. Maksimumin e këtij dënimi KPSH-së parasheh shqiptim deri 25 vjet për dallim nga KPM-së që parasheh deri 20 vjet e për raste të rënda deri në 40 vjet, që shihet se është më i butë si formë e dënimit për nga kohëzgjatja. Për sa i përket dënimit me burg të përjetshëm sipas KPSH-së ky dënim mund të përcaktohet si dënim i pavarur kurse sipas KPM-së ky dënim nuk mund të caktohet si dënim i vetëm.

---

<sup>24</sup> Kodi Penal i Shqipërisë, 2011 shtatorë, neni 29,31,32,33,34.

### 3. DËNIMI ME BURG SIPAS KODIT PENAL TË SËRBIË

Sipas kodit penal të Sërbisë me numër 85/05 dënimi me burgim është i rregulluar me nenet në vijim duke filluar nga neni 44 ku janë të paraqitura dënimet kryesore edhe atë sipas paragrafit 1, dënimi me burg mund të shqiptohet vetëm si dënim kryesorë. Me çka kuptojm se ky dënim sipas sistemit juridik të Sërbisë bën pjesë në dënimet kryesore.

Dënimi me burg sipas nenit 45 të KPS-së<sup>25</sup> është e rregulluar edhe atë në mënyrë taksative si vijon :

- 1) për nga kohëzgjatja e shqiptimit ky dënim nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e as më i gjatë se 20 vjet.
- 2) dënimi me burg jepet në muaj dhe vite të plota kurse për dënimet deri gjashtë muaj edhe në ditë të plota.
- 3) për krimet më të rënda dhe format më të rënda të kryerjes së veprës penale mundet që krahas dënimit sipas paragrafit 1 të këtij neni , në mënyrë të veçantë mund të caktohet dënimi me burg prej 30 deri 40 vjetësh. Dënimi prej 30 deri 40 vjetësh jepet në vite të plota.
- 4) dënimi me burg prej 30 deri 40 vjet nuk mund të caktohet ndaj kryerësve të veprave penale të cilët në kohën e kryerjes nuk i kanë mbushur moshën prej 21 vjetësh.
- 5) nëse kryerësit të veprës penale i caktohet dënim me burg deri 1 vjet, gjyqi njëkohësisht mund të urdhëroj ashtu që dënimi do të vuhet në hapësirat ku jeton duke pasur parasysh personalitetin e kryerësit, jetën e tij të mëparshme, mbajtjen e tij pas kryerjes së veprës, shkallën e veprës dhe rrethanat tjera që kanë ndikuar në kryerjen e veprës, pasi është e pritshme se edhe në atë mënyrë do të arrihet qëllimi i dënimit.
- 6) të dënuarit që i është caktuar dënim me burg sipas paragrafit 5 të këtij neni, nuk mund të largohet nga hapësirat që jeton, me përjashtim vetëm në rastet e parapara me ligj. Nëse i dënuari njëherë në afat prej më tepër se 6 orësh ose dy herë në afat nga 6 orë me vetëdëshirë

---

<sup>25</sup> Kodi Penal i Sërbisë neni 43,44,45.

lëshon hapësirat e caktuara që jeton, gjyqi do të caktoj që pjesën e mbetur të dënimit me burg të mbahet në institucionet shtetërore përkatëse.

7) të dënuarit për veprë penale kundër dhunës familjare dhe martesore i cili jeton me të dëmtuarit në të njëjtën hapësirë dhe rreth familjar nuk mund t'i shqiptohet dënimi me burg sipas paragrafit 5 të këtij neni.

Duke bërë krahasimin në mes KPS-së dhe KPM-së do të vërejmë ngjajshmëritë dhe dallimet duke filluar nga kohëzgjatja e dënimit ku minimumi dhe maksimumi janë pothuajse të njëjta kurse për veprat e kryera në kushte dhe rrethana të rënda sipas KPS-së mund të jepet dënim edhe prej 30 deri në 40 vjet që është zëvendësim e që nuk ekziston në KPS-së burgimi i përjetshëm, gjersa në KPM-së për veprat e rënda kemi dënim me burg të përjetshëm. Ngjajshmëri në mes dy kodeve shihet edhe në dhënien e këtyre dënimeve të rënda, pasi ato kursejnë kryerësit e moshës së re pasi ky dënim mund të shqiptohet ndaj kryerësve që kanë mbushur moshën 21 vjeçare. Në KPS-së në nenin që caktohet dënimi me burg dhe format e saj është e rregulluar në mënyrë decide edhe burgu shtëpiak, që dallon nga KPM-së.

#### **4. DËNIMI ME BURGIM SIPAS KODIT PENAL TË KROACISË**

Kodi penal i Kroacisë me NN 31/93 rregullon dënimin me burg duke filluar prej nenit 32 ku dënimin me burg e llogarit si lloj të dënimeve kryesore që mund të shqiptohet ndaj kryerësve të veprës penale të përgjegjshëm, ku shqiptohet vetëm si dënim kryesorë. Format dhe mënyrat e rregullimit të dënimit me burg janë të caktuara në mënyrë decide në nenin 36 të KPK-së<sup>26</sup> duke filluar nga paragrafi i parë ku rregullohet kohëzgjatja e dënimit me burg duke filluar nga minimumi i dhënies së dënimit me burg që është 15 ditë dhe maksimumi i kohëzgjatjes deri 15 vjet. Kurse për format e rënda të veprës penale kryerësit mund t'i shqiptohet dënim me burg prej 20 vjetësh, e rregulluar në paragrafin e dytë po të këtij neni. Nëse për veprë penale të kryer me paramendim është paraparë dënimi deri në 15 vjet për format e rënda të asaj veprë penale mund të shqiptohet dënim me burg deri 20 vjet. Dënimi me

---

<sup>26</sup> Kodi Penal i Kroacisë, neni 32,33,36.

burg sipas KPK-së shqiptohet në vite dhe muaj të plotë, kurse për dënim deri në 6 muaj edhe në ditë të plota.<sup>27</sup> Për sa i përket hapësirave në të cilat duhet të mbahen dënimet, gjithashtu është e rregulluar në po të njejtin ligj ku në paragrafin 5 theksohet se dënimi me burg mbahet në institucione të tipit të mbyllur, gjysëm të mbyllur dhe të tipit të hapur. Po në këtë nen është paraparë edhe lehtësim nëse mund të llogaritet ku i dënuari që ka mbajtur gjysmën e dënimit, jashtëzakonisht edhe i dënuari që ka vuajtur 2/3 e dënimit , mund të lirohet nga mbajtja e dënimit me kërkesë se deri në kalimin e afatit të dënimit nuk do të kryej vepër të re penale. I dënuari për të shfrytëzuar këtë dispozitë duhet të plotësoj kushtet paraprake duke qenë në vuajtje të dënimit që janë sjellja korrekte, respektim i rregullave ligjore dhe atyre brenda institucionit dhe shpresa se është arritur qëllimi i dënimit apo konkretisht procesi i risocializimit.

Duke bërë krahasimin në mes KPK-së dhe KPM-së në rregullimin e dënimit me burg do të vërejmë se ato në mënyrë formale janë të njejta, kohëzgjatja e dënimit me burg duke filluar nga minimumi ka dallim pasi në KPK-së është 15 ditë kurse në KPM-së është 30 ditë, njejtë edhe për format e rënda të dënimit me burg që në KPK-së kemi dënim me burg prej 20 vjet kurse në KPM-së kemi dënim me burg deri 40 vjet. Si dallim i dukshëm dhe kryesorë vërehet dënimi me burg të përjetshëm ku në KPK-së nuk është i paraparë që kuptojmë se ai është zëvendësuar me dënim me burg deri 20 vjet e gjersa në KPM-së për format e rënda të veprës penale dhe me paramendim është paraparë edhe dënimi me burg të përjetshëm i cili mund të jepet me alternativë prej 40 vjetësh .

## **5. DËNIMI ME BURG SIPAS KODIT PENAL TË MALIT TË ZI**

Sipas kodit penal të Malit të Zi me nr.70/03 janë të rregulluara llojet dhe format e dënimit me burgim duke filluar prej nenit 33 ku janë të paraparë llojet e dënimeve që mund të shqiptohet ndaj kryerësve të veprës penale që janë dënim prej 30 vjetësh, dënim me burgim, dënim me të holla dhe dënim në punë të përgjithshme, ku dënimi me burg deri 30 vjet, dënimi

---

<sup>27</sup> Kodi Penal i Kroacisë, neni 32,33,36.

me burg dhe dënimi me punë në dobi të përgjithshme mund të shqiptohen vetëm si dënime kryesore.<sup>28</sup>

Dënimi me burg prej 30 vjetësh sipas nenit 35 të KPMZi<sup>29</sup> tregon për format dhe mënyrën e shqiptimit të këtij dënimi ku ky dënim prej 30 vjetësh mund t'i shqiptohet kryerësit të veprës penale për format më të rënda. Në paragrafin e dytë të këtij neni parashihet në mënyrë taksative për rastet për të cilat nuk mund të shqiptohet ky dënim prej 30 vjetësh , edhe atë nuk mund të shqiptohet ndaj kryerësve që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur moshën prej 21 vjetësh, kryerësit që në kohën e kryerjes së veprës penale përgjegjësia e të cilit dukshëm ka qenë e zvogëluar dhe vepra penale e mbetur në tentativë. Dënimi me burg rregullohet në nenin 36 të KPMZi<sup>30</sup> ku dënimi me burg nuk mund të jetë në kohëzgjatje më i shkurtër se 30 ditë e as më i gjatë se 20 vjet, poashtu dënimi me burg i këtij neni caktohet në vite dhe muaj të plotë, kurse për dënim deri gjashtë muaj edhe në ditë të plota.

Nëse bëhet krahasim në mes KPMZi dhe KPM-së do të vërejmë ngjajshmëri gjatë llojeve dhe format e dhënies së dënimit me burgim për nga kohëzgjatja dhe caktimi i saj që është pothuajse i ngjajshëm, kurse dallim në mes dy kodeve kemi për çështjen e dënimit me burgim të përjetshëm ku këtë lloj dënimi KPM\_së e parasheh për format e rënda të veprës penale, si alternativë mund të shqiptohet dënim deri në 40 vjet, gjersa KPMZi nuk e parasheh këtë formë të dënimit e në vend të saj apo për format më të rënda të veprës penale dhe të vështira mundë të shqiptohet dënim prej 30 vjetësh.

---

<sup>28</sup> Kodi Penal i Malit Zi , neni 33,35,36.

<sup>29</sup> Po aty, neni 35.

<sup>30</sup> Po aty, neni 36.

### **III - KAPITULLI I TRETË**

#### **ASPEKTET KRIMINOLOGJIKE TË DËNIMIT ME BURG.**

#### **1. FENOMENOLOGJIA E DËNIMIT ME BURG NË GJYKATËN THEMELORE TË TETOVËS PREJ VITIT 2007-2012**

##### **1.1. ECURIA DHE DINAMIKA E DËNIMIT ME BURG**


Një ndër format më të rënda të dënimit për parandalimin e kriminalitetit që i shqiptojnë gjykatat është dënimi me burg apo heqje të lirisë, nga ky shkak dhe kjo arsye kemi zgjedhur këtë problem nga se prania e kriminalitetit është shumë e theksuar dhe sfidë e kohës bashkëkohore, në theks të veçantë në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës.

Duke u nisur nga karakteri sasior dhe cilësor i kriminalitetit gjegjësisht vetë dënimit me burg si formë e sanksionit paraqitet dhe është e rrugës nevoja e një studimi dhe analize e këtij dënimi në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës. Duke paraqitur të gjitha karakteristikat duke filluar nga forma e veprës penale e deri te kryerësi, ku në mënyrë statistikore dhe kronologjike do të jepen të dhëna dhe konkluzat për dënimet me burg gjatë periudhës kohore prej vitit 2007 deri 2012. Nga ideja që të arrihet një punim më i qartë dhe më i saktë do të shfrytëzohen të dhënat dhe evidencat që mbahen në arkivin e gjykatës themelore të Tetovës dhe të dhënat nga enti për statistik i Republikës së Maqedonisë për dënimin me burg si formë e sanksionit për vitet 2007-2012. Duke u bazuar në të dhënat e sakta, analizën dhe shikimin e rasteve individuale në mënyrë të drejtpërdrejtë të lëndëve në arkiv do të mundohemi që të analizojmë të dhënat e fituara dhe pastaj paraqitjen e tyre në formë sa më të saktë që të arrihet një pasqyrë reale në lidhje me këtë dukuri negative. Ecuria dhe dinamika e këtij fenomeni negativ është preokupim edhe për shoqërinë tonë, gjegjësisht me theks të veçantë në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës ku me të dhënat që do të paraqesim në tabelat në vazhdim do të njihemi me numrin apo sasinë e veprave penale të dënuar me burgim në mënyrë kronologjike për vitet 2007-2012.

## NUMRI I VEPRAVE PENALE TË DËNUAR ME BURG.

*Tabela numër 1.*<sup>31</sup>

VITI I KRYERJES	NUMRI I VEPRAVE PENALE TË DËNUAR ME BURGIM	GJITHSEJTË
2007	106	
2008	132	
2009	154	
2010	213	
2011	313	
2012	338	1256



Në tabelën numër 1 kemi paraqitur numrin e veprave penale në vitet e caktuara me çka shihet qartë numri i të dënuarve brenda një viti në procedurë gjyqësore me vendim dhe numri i

<sup>31</sup> Të dhëna nga arkivi i Gjykatës Themelore të Tetovës.

përgjithshëm që është 1256. Nga evidencat që mbahen në arkivin e Gjykatës së Tetovës për dënimin me burg për vitet 2007 e deri vitin 2012 ku nëse shikojmë vitet veç e veç del se në vitin 2007 kemi 106 vendime gjyqësore me dënim me burg , në vitin 2008 kemi 132 raste të dënimit me burg , në vitin 2009 kemi 154 raste, në vitin 2010 kemi 213 raste të dënimit me burg të shqiptuar nga gjykata e Tetovës , në vitin 2011 kemi 318 raste dhe në vitin 2012 kemi 338 raste gjithsejtë.<sup>32</sup> Nëse bëjmë një krahasim të dënimit me burg për periudhën e caktuar në bazë të dhënave do të vërejmë se kemi një rritje të madhe të kësaj dukurie ndër vite apo nga viti në vit me çka më pak raste kemi në vitin 2007 dhe atë 106 raste, kurse në vitin 2012 kemi 338 raste të dënimit me burgim, që kuptohet se shoqëria jonë ndër vite preokupohet gjithnjë e më shumë dhe kriminaliteti është në rritje ku shihet nga shifrat. Lidhur me ecurinë e dënimit me burg në Gjykatën Themelore të Tetovës gjatë viteve 2007-2012 rezulton se prej 2007 deri 2012 kemi 17% përqindë rritje të dënimit me burg. Gjithashtu nga këto të dhëna kemi edhe numrin e përgjithshëm apo totalin e dënimit me burg prej vitit 2007 deri 2012 që rezulton se është 1256.

## **1.2. LLOJET E VEPRAVE PENALE DHE DËNIMI ME BURG I TË NJEJTAVE SIPAS LARTËSISË**

Sipas të dhënave që nxorëm gjatë hulumtimit në arkivin e Gjykatës Themelore të Tetovës për dënimin me burg gjatë viteve 2007 deri vitin 2012, në vazhdim do të paraqesim një tabelë në të cilën do të mundohemi të paraqesim të dhënat e shfrytëzuara.

### **LLOJET E VEPRAVE PENALE TË CILAT JANË MË TË SHPESHTA DHE NUMRI I DËNIMEVE ME BURGIM PËR TË NJEJTAT.**

***Tabela numër 2:***

<b>Llojet e veprave penale</b>	<b>Viti 2007</b>	<b>Vitit 2008</b>	<b>Viti 2009</b>	<b>Viti 2010</b>	<b>Viti 2011</b>	<b>Viti 2012</b>
<b>Vrasje</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>11</b>	<b>7</b>	<b>5</b>
<b>Lëndime të rënda</b>	<b>3</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>11</b>	<b>6</b>	<b>7</b>

<sup>32</sup> Të dhënat e bazuara nga evidenca në arkivën e Gjykatës Themelore të Tetovës për vitet 2007-2012.



trupore						
Lëndime trupore	7	6	8	6	18	10
Vjedhje	9	12	13	10	24	30
Vjedhje e rëndë	13	16	15	20	36	24
Dhunim	4	6	6	10	8	10
Përdhunim	2	1	3	1	5	5
Mashtrim	0	2	5	9	7	17
Lëshim në qarkullim i lëndëve narkotike	13	12	16	10	14	21
Armëmbajtjeje pa leje	12	13	14	12	16	18
Falsifikim i dokumenteve	11	13	17	18	33	24
Keqpërdorim i detyrës zyrtare	0	1	2	0	3	0 <sup>33</sup>
Ndërtim pa leje	0	1	0	1	1	8
Mashtrim doganor	1	2	3	2	5	8
Shkaktim të rrezikut të përgjithshëm	2	2	1	4	4	2
Grabitje	2	4	3	5	6	5
Shfrytëzim i pa autorizuar i firmës huaj	3	4	3	0	7	7
Tregti me njerëz	1	0	2	1	2	1
Falsifikim i parave	1	2	2	1	3	0
Gjithsejtë	99	105	121	142	202	203
Vepra të tjera penale	7	27	33	71	111	135

<sup>33</sup> Të dhëna nga arkiva e Gjykatës Themelore të Tetovës.

Në tabelën e radhës do të paraqesim dënimin me burg sipas lartësisë së tij që shqiptohet nga Gjykata e Tetovës për veprat penale të kryera gjatë viteve 2007 deri 2012.

**Tabela numër 3:<sup>34</sup>**

VITI	6 muaj- 1 vjet	2-3 vite	4-6 vite	7-10 vite	11-15 vite
<b>2007</b>	<b>57</b>	<b>28</b>	<b>13</b>	<b>2</b>	<b>2</b>
<b>2008</b>	<b>68</b>	<b>42</b>	<b>17</b>	<b>3</b>	<b>2</b>
<b>2009</b>	<b>81</b>	<b>56</b>	<b>12</b>	<b>4</b>	<b>1</b>
<b>2010</b>	<b>99</b>	<b>90</b>	<b>13</b>	<b>5</b>	<b>4</b>
<b>2011</b>	<b>147</b>	<b>145</b>	<b>16</b>	<b>4</b>	<b>0</b>
<b>2012</b>	<b>160</b>	<b>126</b>	<b>17</b>	<b>8</b>	<b>3</b>
<b>Gjithsejtë</b>	<b>612</b>	<b>487</b>	<b>88</b>	<b>22</b>	<b>12</b>

35

Në tabelën e paraqitur nga të dhënat shihet qartë lartësia e dënimit me burg të shqiptuar ndaj personave që kanë kryer vepra penale të rënda nga ana e Gjykatës Themelore të Tetovës për vitet 2007 deri 2012. Të dhënat që shfrytëzohen janë të mara nga statistikat dhe shënimet që mbahen në arkivin e Gjykatës Themelore të Tetovës për vitet e theksuara. Tabela paraqet të dhëna në vite të ndryshme duke precizuar dhe ndarë ato ku vërehet se më tepër dënime me burg kemi dënime me kohëzgjatje më të vogël edhe atë prej 6 muajsh deri 1 vjet që rezultojnë me 552 raste, një numër i lartë nëse shihet nga aspekti se kjo moshë është tepër delikate, këtë dënim nëse e shikojmë në vite të ndryshme duke filluar nga viti 2007 nga ky dënim kemi 57 raste dhe deri në vitin 2012 po ashtu ky dënim arrinë shifrën prej 160 rastesh ku nënkuptojmë se kemi rritje drastike të këtij dënimi, gjegjësisht këtë kategori të moshës të dënuar, qartë shihet se me kalimin e viteve kemi rritje të madhe të kriminalitetit. Dënimi me burg prej 2 deri 3 vite si kategori e dytë e dënimit me burg sipas lartësisë gjithashtu bën pjesë në grupin ku kemi më tepër të dënuar ku numri i përgjithshëm për vitet 2007 deri 2012 përafërsisht arrinë në 481 raste. Dënimi me burg prej 4 deri 6 vite burg si lloj i tretë, këtu shihet

<sup>34</sup> Të dhëna na arkiva e Gjykatës Themelore të Tetovës.

<sup>35</sup> Po aty.

se numri ndër vite nuk është i lartë dhe shihet një mesatare e përgjithshme që nuk ndryshon e që në total kemi 88 raste. Kategoria e katërt ku bën pjesë dënimi me burg prej 7 deri 10 vite që është dënim i rëndë kemi 26 raste ku njëjtë sikurse te kategoritë tjera edhe në këtë formë të dënimit prej vitit 2007 e deri në vitin 2012 numri i rasteve rritet prej viti në vit, shembull, në vitin 2007 kemi 2 raste e gjersa në vitin 2012 arrin deri 8 raste. Forma më e rëndë e dënimit me burg apo maksimumi i shqiptimit të dënimit me burg që është 11 deri 15 vite që e kemi si kategori e pestë rezulton në 12 raste për vitet 2007 deri 2012. Më tepër dënime të këtij lloji kemi në vitin 2010 edhe atë 4 raste kurse në vitet tjera numri është më i ulët, siç shihet edhe në tabelë.

### **1.3. MOSHA E TË DËNUARVE ME BURGIM**

Si karakteristik e rëndësishme e personalitetit dhe fenomenit kriminal është edhe mosha. Të dhënat e shumta statistikore nga praktika gjyqësore si dhe shënimet empirike kriminologjike, flasin se me veprime dhe sjellje kriminale merren persona të moshave të ndryshme.<sup>36</sup>

Duke u bazuar në punimin tonë në tabelën që kemi paraqitur jemi munduar që të japim të dhëna nga evidencat e Gjykatës të Tetovës për moshën e të dënuarve madhorë gjegjësisht për të rriturit. Kemi bërë një ndarje për moshën e të dënuarve duke filluar nga mosha 18 vjeçare e deri 25 vjeçare që llogaritet si moshë e veçantë pastaj prej moshës 26 deri 39 vjeçare, nga mosha 40 deri 59 vjeç dhe kategoria e fundit e moshës mbi 60 vjet. Nga literatura kriminologjike dhe të dhënat nga praktika gjyqësore del se grupet e tilla të moshave të kryerësve të veprave penale, pak a shumë janë të njëjta në të gjitha vendet e botës me oscilime shumë të vogla, prej një regjioni në regjionin tjetër, e sidomos prej brezave të ndryshëm klimatikë në breza tjerë.<sup>37</sup> Mosha e njeriut paraqet kategori biologjike dhe sociale e cila në literaturë paraqitet si një ndër faktorët më të rëndësishëm në realizimin e procesit të riedukimit ndaj personave të dënuar. Rëndësia e saj në procesin e vuajtjes së dënimit është ngushtë e

<sup>36</sup> Halili.Ragip,Kriminologjia,Prishtinë,2011,faqe 129.

<sup>37</sup> Po aty,faqe.130.

lidhur me qëllimin e dënimit qoftë ai penal apo kriminologjik dhe në bazë të këtij qëllimi qëndron kuptimi se njeriu është qenie e cila ndryshon dhe përmirësohet. Prandaj, nuk kemi të bëjmë me atë se ato që i kanë prishur marrëdhëniet shoqërore, vlerat dhe interesat e një shoqërie janë të mitur, madhorë të rijne, madhorë ose persona në moshë. Në të gjitha këto periudha të moshës karakteristikat e personalitetit të tyre formohen dhe manifestohen varësisht nga kushtet biologjike dhe psikologjike.<sup>38</sup> Nga e gjithë kjo kuptojmë se sjellja e njeriut, qoftë edhe ajo më e rënda kriminale lidhet ngushtë me veçori të ndara të moshës. Këto veçori në faza të caktuara janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën, në bazë të ndikimeve shoqërore, të cilat ndikime përcaktojnë statusin e tyre shoqërorë dhe rolin e ambientit të dhënë varësisht nga mosha formohen dhe veçoritë sociale të personalitetit, mundësia dhe gatishmëria e tyre në marrëdhënie shoqërore dhe ballafaqimin me një numër problemesh dhe konfliktesh të cilat dalin nga këto marrëdhënie.<sup>39</sup> Në vazhdim do të paraqesim në mënyrë tabelare kryerësit e veprës penale sipas moshës, në Gjykatën Themelore të Tetovës gjatë viteve 2007-2012 duke i ndarë ato në disa kategori:

***Tabela numër 4:***

<b>Viti</b>	<b>Prej 18-25 vjeç</b>	<b>Prej 26-39 vjeç</b>	<b>Prej 40-59 vjeç</b>	<b>Mbi 60 vjet</b>
<b>2007</b>	<b>20</b>	<b>53</b>	<b>47</b>	<b>6</b>
<b>2008</b>	<b>25</b>	<b>37</b>	<b>60</b>	<b>10</b>
<b>2009</b>	<b>32</b>	<b>41</b>	<b>60</b>	<b>12</b>
<b>2010</b>	<b>49</b>	<b>89</b>	<b>38</b>	<b>17</b>
<b>2011</b>	<b>58</b>	<b>108</b>	<b>111</b>	<b>20</b>
<b>2012</b>	<b>61</b>	<b>102</b>	<b>133</b>	<b>22</b>
<b>Gjithsejtë</b>	<b>245</b>	<b>430</b>	<b>449</b>	<b>87</b>

Të dhënat që kemi paraqitur në tabelë është prekëse fakti pasi mosha më e ndjeshme prej 18 vjet e deri në 25 vjet paraqitet si pjesëmarrës me numër më të lartë në kriminalitet

<sup>38</sup> Sulejmanov.Zoran, Ubistvata vo Makedonija,Skopje,1995,faqe 124.

<sup>39</sup> Po aty.

edhe pse në krahasim me moshën aktive është më i ulët që është mosha prej 26 deri 39 dhe kategoria tjetër prej 40 deri 59 që si kategori e moshës aktive nga të dhënat del si moshë ku kemi më tepër të dënuar. Më pak raste kemi për moshën apo mbi moshën 60 vjeçare që llogaritet si moshë pasive e që rezulton me realitetin edhe nga të dhënat për territorin e Gjykatës së Tetovës.

#### **1.4. GJINIA E TË DËNUARVE ME BURGIM**

Gjinia apo përkatësia seksuale në pjesëmarrjen e kriminalitetit gjithashtu vështrohet në literaturën kriminologjike dhe interpretohet nga këndvështrime të ndryshme. Ekziston një përshtypje e përgjithshme në bazë të dhënave të statistikës kriminale dhe praktikës gjyqësore, se kriminaliteti është një dukuri tipike e gjinisë mashkullore.<sup>40</sup> Gjë që vërehet dhe është prezente edhe në vendin tonë apo gjegjësisht në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës, pasi sipas të dhënave dhe statistikave del se gjinia e cila është aktive apo më tepër pjesëmarrëse në kriminalitet është gjinia mashkullore, dhe atë në shifra dhe numra shumë më të lartë në krahasim me gjininë femërore. Edhe për kundër faktit që kriminaliteti paraqitet si dukuri tipike mashkullore, kjo nuk nënkupton se meshkujt nuk janë viktimë. Nëse i qasemi studimeve viktimologjike do të shohim se tek veprat penale të vrasjes në të shumtën e rasteve si viktima na paraqiten personat e gjinisë mashkullore. Mirëpo kjo nuk anashkalon edhe femrën si viktimë e krimit të vrasjes.<sup>41</sup>

Në vazhdim do të paraqesim tabelën me anë të së cilës do të vërejmë gjininë e kryerësve të veprave penale në territorin e Gjykatës të Tetovës për vitet 2007-2012 , të dhëna këto të mara nga evidencat dhe statistikat që mbahen në arkivin e gjykatës:

---


<sup>40</sup> Halili.Ragip,Kriminologjia,Prishtinë,2011,faqe.131.

<sup>41</sup> Po aty,faqe 137.

**Tabela numër 5:<sup>42</sup>**

**KRYERËSIT E VEPRAVE PENALE SIPAS GJINISË**

VITI	Mashkull	Femër
2007	98	3
2008	125	5
2009	144	9
2010	202	11
2011	299	14
2012	321	17
Gjithësejt	1189	67



Nga të dhënat që janë të paraqitura në tabelë kemi numrat e saktë për gjininë për vitet 2007 deri vitin 2012. Gjinia mashkullore si gjini që dominon në kriminalitet edhe në territorin e

<sup>42</sup> Të dhëna nga arkivi i Gjykatës Themelore të Tetovës.

Gjykatës Themelore të Tetovës del se në vitin 2007 kemi 98 raste dhe ky numër me kalimin e viteve shkon duke u rritur dhe atë duke u dyfishuar e trefishuar dhe bashkë me rritjen e veprave penale ndër vite arrin shifrën në 1189 raste deri në vitin 2012, nga kuptohet se kriminaliteti ka një rritje dhe shoqëria jonë është në rrezik të madh nga kjo gjini . Mirëpo duhet theksuar se te disa sjellje kriminale dhe vepra penale pjesëmarrja e femrës është më e madhe. Karakteristika e kriminalitetit të femrave është edhe fakti se ato më tepër marin pjesë në kryerjen e krimeve si ndihmëse, shtytëse e më pak si kryerëse e drejtpërdrejtë apo organizatore e krimeve të caktuara.<sup>43</sup> Me globalizimin dhe me afirmimin e gjinisë femërore në shoqërinë bashkëkohore është normale dhe e pritshme se numri i krimeve që kryhen nga kjo gjini do të rritet, dukuri që shihet edhe në shoqërinë tonë gjegjësisht edhe në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës, ku në vitin 2007 nga të dhënat në tabelë kemi vetëm 3 raste të dënimit për gjininë femërore dhe ky numër deri në vitin 2012 rritet në mënyrë drastike dhe kap shifrën deri 67 raste. Normalisht ky numër shkon në rritje bashkë me numrin e rritjeve të veprave penale. Në rrethin që kemi paraqitur se sa është numri apo gjegjësisht përqindja e gjinive që marin pjesë në kriminalitet, nëse bëjmë mbledhjen e veprave penale komplet për gjitha vitet kemi gjininë mashkullore me 95% pjesëmarrje dhe atë femërore me 5%.

### **1.5. NACIONALITETI I TË DËNUARVE ME BURGIM**

Nga shkakut se shteti jonë është shtet multinacional, apo si pjesëmarrës në kriminalitet bëjnë pjesë më tepër nacionalitete e pamë të arsyeshme dhe të rrugës që edhe nacionaliteti si karakteristik e personalitetit të dënuarve me burgim të studiohet në bazë të dhënave dhe statistikave që shfrytëzuar nga evidenca e arkivit të Gjykatës Themelore të Tetovës.

Në vazhdim në formë tabelare do të paraqesim një pasqyrë më të plotë të strukturës nacionale të dënuarve me burgim në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës për vitet 2007 deri vitin 2012.

---

<sup>43</sup> Halili.Ragip,Kriminologjia,Prishtinë,2011. faqe 132.

**Tabela numër 6:<sup>44</sup>**

Nacionaliteti i të dënuarve me burgim	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Gjithësejt
Shqiptarë	68	88	92	154	218	210	830
Maqedonas	29	32	39	40	55	72	267
Sërb	/	/	/	1	1	/	2
Turq	1	2	1	3	10	6	23
Romë	6	6	4	9	10	10	45
Boshnjak	/	/	/	1	1	/	2
Të tjerë	20	14	18	7	20	40	119
<b>Gjithsejtë</b>	<b>106</b>	<b>132</b>	<b>154</b>	<b>213</b>	<b>313</b>	<b>338</b>	<b>1288</b>



Personat e dënuar me burg më të shpeshtë sipas të dhënave në tabelën e mësipërme janë të nacionalitetit shqiptarë pastaj maqedonas, të tretët romë, të katërtit turq dhe pastaj të

<sup>44</sup> Të dhëna nga Gjykata Themelore e Tetovës.



tjerët. Edhe atë për brenda viteve prej 2007 deri 2012 për nacionalitetin shqiptarë del numri i përgjithshëm 830 të dënuar apo 64 %, për maqedonasit 267 raste apo 21 %, për romët 45 apo 3%, për turqit 25 apo 2% dhe të tjerët 123 raste apo 10%. Kurse nëse bëjmë krahasimin në mes përqindjes së kryerësve të veprave penale me përqindjen e nacionaliteteve që bëjnë pjesë në territorin e Tetovës është dukshme se përafërsisht janë të njëjtë në kryerjen e veprave penale.

## 1.6. RECIDIVIZMI

Me recidivizëm nënkuptojmë kur personi i dënuar një herë për vepër penale kryen apo përsërit të njëjtën ose vepër penale të llojit tjetër. Recidivizmi ose përsëritja e sjelljeve kriminale, gjithashtu paraqet një formë të veçantë të manifestimit të kriminalitetit, që në vete ndërlidh rrezikshmëri të posaçme shoqërore.<sup>45</sup> Si lloj i tillë recidivizmi apo vet individi recidivist është problematik i kohës bashkëkohore me të cilën merren teoritë dhe shkencat përkatëse për përkufizim dhe definimin në mënyrë sa më të plotë dhe më të saktë. Recidivizmi apo përsëritja e veprave penale dhe sjelljeve kriminale mund të vështrohet nga aspekti juridiko-penal, kriminologjik dhe penologjik.<sup>46</sup> Në punimin tonë është e nevojshme të shpjegohet aspekti apo kuptimi penalo juridik pasi këtu recidivizmi lidhet me kryerësin i cili përsëritën veprën penale edhe pse më parë është dënuar për ndonjë vepër penale të njëjtë apo të llojit tjetër. Recidivi ka rëndësi në aspektin penalo-juridik, kriminologjik dhe penologjik. Rëndësia penalo juridike konsiston në faktin se dënimi i mëparshëm nuk ka ushtruar ndikim efikas në përmirësimin e kryerësit të veprës penale, andaj ndaj tij duhet të shqiptohet dënimi më i rëndë. Në këto raste recidivi konsiderohet si rrethanë rënduese. Rëndësia kriminologjike e recidivit konsiston në rrezikshmëri shoqërore të zmadhuar të kryerësit të veprës penale në shtimin e kriminalitetit dhe në joefikasitetin e masave penalo juridike që janë zbatuar. Rëndësia penologjike e recidivit konsiston në faktin se masat e ndërmarra të enteve ndëshkuese-përmirësuese nuk kanë pasur sukses në riedukimin e kryerësit të veprës penale dhe ndaj tij duhet aplikuar një trajtim të

---

<sup>45</sup> Halili.Ragip,Kriminologjia,Prishtinë, 2011, shih faqe 229.

<sup>46</sup> Po aty, faqe 229.

posaçëm, special<sup>47</sup>. Varësisht se prej çfar aspekti vështrohet, në shkencën e së drejtës penale njihen disa lloje të recidivit. Duke marrë për bazë natyrën e veprës penale kemi recidiv të përgjithshëm dhe ai special. Recidivi i përgjithshëm ekziston kur kryerësi, pas dënimit të shqiptuar apo të mbajtur për veprën penale të mëparshme, sërish kryen vepër penale të llojit të ndryshëm. Recidivi special apo i posaçëm, ekziston kur kryerësi, pas dënimit të shqiptuar apo të mbajtur për veprën penale të mëparshme, sërish kryen vepër penale të llojit të njëjtë.<sup>48</sup>

Në vazhdim do të mundohemi në bazë të dhënave që arritëm t'i nxjerrim nga evidencat e arkivit nga Gjykata e Tetovës për vitet 2007 deri 2012 në formë tabelare të paraqesim recidivizmin si fenomen edhe në këtë territor ku nëpërmjet numrave ndër vite do të kuptojmë se sa është i pranishëm recidivizmi apo gjegjësisht përsëritja e veprave penale nga të dënuarit e njëjtë dhe ndryshimin e saj ndër vite.

***Tabela numër 7:<sup>49</sup>***

**KRYERËSIT E VEPRËS PENALE SIPAS RECIDIVIZMIT**

<b>Viti</b>	<b>Primarë</b>	<b>Recidivist</b>
<b>2007</b>	<b>106</b>	<b>4</b>
<b>2008</b>	<b>132</b>	<b>5</b>
<b>2009</b>	<b>154</b>	<b>4</b>
<b>2010</b>	<b>213</b>	<b>13</b>
<b>2011</b>	<b>313</b>	<b>18</b>
<b>2012</b>	<b>338</b>	<b>26</b>
<b>Gjithësejt</b>	<b>1256</b>	<b>70</b>

Dallimi apo përqindje relativisht e lartë paraqitet në mes kryerësve primar dhe atyre recidivist ku në total si kryerës primar kemi 1256 raste e gjersa recidivist na paraqiten 70 raste që është numër edhe pse i vogël prapë se prapë shqetësues.

<sup>47</sup> Saliu, Ismet, Vepra e cituar, Prishtinë, 2003, faqe 512.

<sup>48</sup> Po aty, faqe 512, 513.

<sup>49</sup> Të dhëna nga Gjykata Themelore e Tetovës.

## 1.7. GJENDJA MARTESORE DHE STATUSI FAMILJARË

Rëndësi në punimin tonë që duhet trajtuar është edhe gjendja martesore dhe statusi familjar i kryerësve të veprës penale si karakteristik personale. Me anë të kësaj karakteristike mundësohet të veheet në dukje gjendja e mëparshme gjegjësisht në kohën e kryerjes së veprës penale se cila ka qenë statusi që mund të jetë i martuar, i pamartuar, i ndarë apo i vejë. Ku nëpërmjet kësaj gjendje arrihet llogaritje se cila gjendje martesore është krijues apo shtytës i personave për vepra kriminale, nga disa të dhëna në shtetet evropiane si kategori prej së cilës dalin më tepër persona kriminal janë personat e martuar. Nga shkakut i krijimit të familjes marrëdhëniet në mes çiftit, varfëria dhe papunësia që pamundëson krijimin e kushteve normale, zhvillimi dhe globalizimi që vështir arrihet dhe ndjeket trendi i kohës bashkëkohore, mosedukimi i fëmijëve në formën e duhur dhe disa faktorë të tjerë tregojnë se personat që kryejnë vepra penale apo kriminelët me numër më të madhë janë personat me gjendje familjare të martuar.

Konkretisht në punimin tonë edhe pse me shumë vështirësi kemi arritur të nxjerrim disa numra nga evidence e Gjykatës Themelore të Tetovës rreth gjendjes martesore për personat e dënuar me burgim në Gjykatën e Tetovës për vitet 2007 deri vitin 2012, të cilat do t'i paraqesim në tabelën e më poshtme, me anë të cilave do të mundohemi të tregojmë se sipas cilës gjendje martesore kemi më tepër kryerës të veprave penale apo të burgosur në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës.

KRYERËSIT APO TË DËNUARIT ME BURG SIPAS GJENDJES MARTESORE DHE STATUTIT FAMILJAR.

***Tabela numër 8:<sup>50</sup>***

Viti	Të pa martuar	Të martuar	Të ndarë
2007	18	73	/
2008	33	80	/
2009	19	79	/

<sup>50</sup> Të dhëna nga arkivi i Gjykatës Themelore të Tetovës.

<b>2010</b>	<b>21</b>	<b>71</b>	<b>/</b>
<b>2011</b>	<b>49</b>	<b>223</b>	<b>/</b>
<b>2012</b>	<b>38</b>	<b>281</b>	<b>/</b>
<b>Gjithsejtë</b>	<b>178</b>	<b>807</b>	<b>/</b>

Në bazë të dhënave dhe numrave të nxjerra nga arkiva e Gjykatës Themelore të Tetovës vërehet se numri më i madh i të dënuarve me burg janë të martuar, që shihet prej viti në vit gjersa në krahasim me personat e pa martuar numri është më i ulët, konkretisht në përgjithësi apo gjithsejtë nëse bëjmë mbledhjen e numrave për pesë vite del se kemi 807 persona të martuar kanë kryer vepra penale apo gjegjësisht të burgosur, ky numër është shumë më i lartë se numri i personave të pa martuar që është 178. Kurse te kategoria e personave të vejë dhe të ndarë, nuk kemi numra konkret dhe të dhëna statistikore me çka llogarisim se nuk kemi edhe pse nuk përjashtohet për lëshime dhe raste të mundshme. Edhe në rrethin tonë nga shkakun që kryerësit më të mëdhenj paraqiten personat me status apo gjendje martesore të martuar në krahasim me personat e pa martuar dhe atyre të vejë apo të ndarë, si faktorë për paraqitjen e personave kriminal në këtë kategori mund të merret pikërisht martesën. Me martesën dhe bashkëjetesën siç cekëm edhe më lartë lindin kërkesat dhe përkushtimet që duhet plotësuar dhe përmbushur brenda saj siç janë faktorët apo kushtet ekonomike sociale e që në të kundërtën nga mos përmbushja e tyre vjen deri te personat që kryejnë vepra penale.

## 2.ASPEKTI ETIOLOGJIK, SHKAQET QË KUSHTËZOJNË KRYERËSIN TË KRYEJË VEPËR PENALE

### 2.1. SHKAQET APO FAKTORËT OBJEKTIV (të jashtëm)

#### 2.1.1.VARFËRIA DHE PAPUNËSIA

Si një ndër faktorët më kryesorë prej të cilit rrjedh kriminaliteti llogaritet edhe varfëria, që paraqitet si shkak i kushteve të rënda ekonomike dhe krizave të rënda prej të cilave vihet në pikëpyetje ekzistenca për një jetë më normale e vet individit por edhe të familjes në përgjithësi. Për kriminalitetin që lind si pasoj e varfërisë ka patur shumë diskutime rreth sqarimit të kësaj dukurie, ku edhe filozofi i njohur Aristoteli është marrë me këtë dukuri i cili ka thënë se **“varfëria është nëna e kimit , ndërsa begatia nëna e amoralitetit”**.<sup>51</sup> Nga vet thënia e lartpërmendur kuptojmë se edhe pse varfëria është shkaktar i paraqitjes kriminalitetit ajo nuk është shkaktar absolut dhe i pavarur sepse praktika tregon se njerëzit që jetojnë në begati dhe pasuri janë kategoria ndoshta më e keqe dhe që mund të kryejnë vepra kriminale prej më të rëndave, duke filluar nga bizneset jolegale, udhëheqësit e ndryshëm, diktatorët që për epshet dhe idetë e tyre kanë kryer vepra nga më të rëndat. Shpesh individët apo familjet skamnore janë pre dhe viktima të të pasurve. Varfëria llogaritet se është shkaktare e veprave më të vogla si ato të vjedhjes por me kalimin e kohës arihet deri te afrimi dhe mundësia për të kryer vepra të rënda kriminale.

Papunësia, është e ngjajshme me dukurinë e varfërisë dhe ka të bëjë me pamundësinë e punësimit dhe kyçjen në punë të njerëzve , e kjo sjell mungesën e mjeteve për ekzistencë.<sup>52</sup> Efektet negative që i shkakton papunësia janë pothuajse të njejta me atë të varfërisë pasi me humbjen e vendit të punës apo mos mundësinë për kyçje në jetë dhe punë aktive personi shkon drejtë varfërisë. Me gjendjen e rëndë ekonomike dhe mos përmbushjen nevojave elementare, financiare, familjare e tjera e që janë shkak që shtynë personin apo individin deri te kryerja e veprave kriminale. Edhe në shtetin tonë problem kryesorë është papunësia, sfida kryesore e

---

<sup>51</sup> Halili.Ragip,Kriminologjia,Prishtinë,2011,faqe 249.

<sup>52</sup> Po aty, faqe 249.

çdo qeverie është luftimi apo përpjekja për zvogëlimin e numrit të papunësisë i cili në krahasim me shtetet evropiane është shumë i lartë.

Në vazhdim do të paraqesim një tabelë me të cilën do të tregojmë se sa është numri i papunësisë i personave të dënuar me burgim në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës gjatë viteve 2007 deri vitin 2012.

**Tabela numër 9.<sup>53</sup>**

Viti	Të pa punësuar
2007	29.7 %
2008	30.4 %
2009	31.6 %
2010	29 %
2011	25 %
2012	/

Nga të dhënat që shohim në tabelën e mësipërme vërejmë se papunësia në Tetovë është shumë e lartë, ku si përqindje mesatare për vitet 2007 deri vitin 2012 kemi 29% përqindshin, shifër kjo alarmante dhe shumë e lartë. Në krahasim me shtetet e Evropës ku numri i papunësisë është afër 5 %.

### 2.1.2. FAMILJA DHE RRETHI FAMILJARË

Bërthama kryesore e shoqërisë brenda të cilës bëhet zhvillimi dhe formimi i personalitetit të njeriut padyshim se është **familja**. Në familje zhvillohen apo arrihen shumë funksione për një jetë më të mirë siç janë shtimi i saj, edukimi i fëmijëve, zhvillimi, ngritja kulturore , morale, arsimit, punësimi dhe shumë procese tjera që të arrihet një pavarësi dhe jetë e shëndoshë në bazë të rregullave ligjore , hyjnore dhe fetare, larg problemeve dhe

<sup>53</sup> Enti shtetërorë për statistik i Republikës së Maqedonisë.

kriminalitetit. Si e para në kuptimin pozitiv familja si kategori apo çerdhe ka për obligim edukimin e fëmijëve brenda familjes, marrëdhënie dhe kontakte të shëndosha në mes bashkëshortëve në mes anëtarëve të familjes më të gjërë pastaj arsimimin, ngritjen, përkrahjen morale dhe financiare, respektimin e rrethit dhe shoqërisë ku jeton e deri te respektimi i normave dhe rregullave ligjore, morale dhe fetare. Pra këto mund të quhen familje të shëndosha apo familje ideale në kuptimin e plotë të fjalës. Familja është pasqyra apo tregues i sjelljes dhe dukjes të antarëve të vet që në shoqëri është prezente kjo dukuri ku kemi familje që këto veti i arrin me sukses dhe mund të themi se janë familje të shëndosha, kurse në krahasim me familjet tjera kemi edhe prej atyre me probleme që në praktik njihen si familje të degraduara që janë si vatër e krijimit të problemeve të shumta dhe kryerjen e veprave penale apo daljen e delikuentëve dhe kriminelëve po prej këtyre familjeve. Familja si kategori mund të studiohet në dy forma në mënyrën e parë ajo është parandalues për përhapjen e krimit kurse nga ana tjetër ajo është shkaktar kryesorë për paraqitjen e krimit dhe veprave kriminale në shoqëri, andaj jemi munduar që sa do pak të shpjegojmë këto dukuri. Kur flitet për ndikimin e familjes dhe raporteve familjare në sjelljet kriminale të fëmijëve dhe të miturve është me rëndësi të theksohet se nuk duhet të absolutizohet përtej mase ndikimi i familjes. Këtë faktor përherë duhet ndërlidhur me faktorë të tjerë që ndikojnë në raportet familjare e sidomos në kushtet ekonomike, kulturore, papunësinë, varfërinë, etj.<sup>54</sup> Nga ky citat nënkuptojmë se familja është e pamundur të jetë e pavarur nga faktorët tjerë bile edhe e lidhur ngushtë me faktorët që përmendëm siç janë ndër të parat kushtet ekonomike që ndikojnë në zhvillimin e jetës normale e që prej aty rrjedh gjendja e tyre që mund të jetë e pasur apo e varfër me çka pengohet arritja e kushteve elementare, barazia me rrethin ku jeton, pamundësia për zhvillim dhe arsimim, ngritja e personalitetit e që shpesh këto janë arsye që shtynë deri te shfaqja dhe kryerja e veprave penale dhe kriminalitetit. Me globalizimin dhe kohën bashkëkohore moderne familja si bashkësi ka pësuar ndryshime dhe transformime si në aspektin ekonomik, social dhe atë të zhvillimit të teknologjisë. Shpeshherë, procesi i transformimit të familjes dhe shëndrimi i sajë në një bashkësi moderne po përcillet edhe në kriza, konflikte, tronditje dhe trauma të ndryshme. Emancipimi dhe liria e pa tjetërsuar e femrës nga normat tradicionale konzervative, ka ndikuar

---

<sup>54</sup> Halili.Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, faqe.277.

që funksionet e familjes të ndryshojnë në shumë aspekte.<sup>55</sup> Me këto ndryshime që mundësuan emancipimin dhe avancimin e femrës në shoqëri dhe mundësinë dhe nevojën që të jenë aktive në punë në anën tjetër u humb dhe u zbeh roli i saj si shtylla kryesore e familjes në arritjen e edukimit familjar të fëmijëve dhe kujdesi për ta por edhe ndaj anëtarëve tjerë. Kjo dukuri bashkë me faktorët tjerë që janë kushtet e rënda ekonomike dhe të banimit, konfliktet brenda anëtarëve dobësojnë dhe shkatërrojnë ndikimin e familjes ndaj anëtarëve të vet dhe hapet rruga apo mundësia për paraqitjen apo lindjen e delikuentëve dhe kriminelëve. Për familjen flet edhe shkrimtari i njohur **Leon Tolstoi** i cili në romanin e tij **“Ana Karenina”** thotë: **“të gjitha familjet fatlume i ngjajnë njëra tjetrës, ndërsa familjet fatkeqe janë të tilla në mënyrën e vet”**.<sup>56</sup> Edhe vet shkrimtari i njohur bën një ndarje të familjes që ndikon në atë se ajo do të jetë pozitive apo si burim i zhvillimit të kriminalitetit. Nga ky aspekt vjen në shprehje edhe ndarja apo dallimi i paraqitjes të llojeve të familjes që janë familjet e degraduara, familjet deficite apo të mangëta dhe familjet shumë anëtarëshe.

Si lloji i familjeve prej të cilave paraqiten apo dalin kriminelët dhe delikuentet njihet lloji i familjeve të degraduara apo ndryshe njihen edhe si familje problematike dhe të shkatëruara. Nga gjendja e rëndë ekonomike të këto familje paraqiten problemet mes anëtarëve të familjes ku fillon me konfliktet në mes bashkëshortëve, pastaj ndarja e tyre apo divorci, ikja e njërit apo e të dyve, lënia e fëmijëve pa mbikëqyrje dhe përkujdesje, me çka gjitha këto probleme reflektojnë te fëmijët dhe fillojnë edhe problemet psikike dhe shpirtërore me çka mundëson nisjen apo kryerjen e sjelljeve të padëshiruara dhe fatale për ta siç janë ikja nga shtëpia, bredhja rrugëve dhe pastaj rënia e tyre në duar të zeza me çka shumë shpejt ato bëhen vegël që shfrytëzohen për vepra kriminale, njëherë më të lehta si vjedhjet, përdorimi dhe shitja e substancave narkotike pastaj me kalimin e kohës dhe aftësimin e tyre dhe kryerjen deri te veprat penale më të rëndat. Praktika tregon se kriminelët apo delikuentet me numër më të madh rrjedhin pikërisht nga ky lloji i familjes ku si rezultat i problemeve dhe ndarjeve bashkëshortore, edukimit dhe emancipimit të fëmijëve pamundësohet mbykqirja e fëmijëve, pamundësohet zhvillimi i tyre normal në të gjitha aspektet dhe proceset e jetës. Familjet

---

<sup>55</sup> Halili.Ragip,Kriminologjia,Prishtinë,2011,faqe 277.

<sup>56</sup> Po aty, faqe 280.



deficite apo familje të mangëta është lloji tjetër i familjeve nga linden kryerësit e veprave penale. Si të tilla trajtohen familjet në të cilat mungojnë të dy prindët apo vetëm njëri nga ata. Këto mungesa të prindërve mund të jenë shkak të proceseve natyrore të vdekjes, ndarjes së prindërve, braktisjes nga njëri prindë, shkuarjes në botën e jashtme për shkak të punësimit dhe veçmas si pasojë e luftës.<sup>57</sup> Duke marrë parasysh se nga mungesa e njërit apo dy prindërve edukimi i fëmijëve zbehet dhe është vështirë ato të mbikëqyren nga persona të tretë apo nga organe shtetërore në mënyrë efikase dhe të drejtë ku si pasojë e kësaj paraqiten problemet shpirtërore, psiqike pastaj edhe ekonomike deri te afrimi shumë më i lehtë me krimin. Është e njohur se në shtete me popullsi të madhe kjo kategori e fëmijëve shpesh edhe keqpërdoren nga persona dhe grupe të ndryshme për qëllimet e tyre të errëta dhe kriminale. Familjet me shumë anëtarë apo ndryshe siç njihen familjet me numër të madh të fëmijëve janë familje që kanë ndikim kriminal. Problemi kryesorë në këtë kategori të familjes është skamja apo varfëria që arrijnë deri te problemi i ekzistencës. Mos pasja e kushteve elementare për jetesë duke filluar nga veshmbathjet , materialet shkollore , shpesh edhe mungesa e ushqimit, ndikimi i problemeve familjare te fëmijët, janë shkaktarë kryesorë që këto fëmijë që në moshë të hershme fillojnë të merren me vepra kriminale.

### **2.1.3. SHKOLLA SI FAKTORË OBJEKTIV I KRIMINALITETIT**

Si institucioni kryesorë që ka rol të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve menjëherë pas familjes është shkolla dhe ambienti shkollor. Edukatën e parë fëmija e merr kryesisht nga prindët dhe rrethi familjar, kurse edukimi dhe arsimimi i tij në jetën e mëtutjeshme gjithsesi se varet nga shkolla. Gjatë edukimit dhe emancipimit në shkollë, fëmijët fitojnë njohuri dhe shprehje për të gjitha sferat si në aspektin profesional ashtu edhe në edukimin dhe në përsosjen e personalitetit. Në studimin tonë me interes është se si shkolla si faktor nxit kriminalitetin. Nga teori dhe shkrime të ndryshme kemi ide se kushtet jo adekuate apo të papërshtatshme, duke u nisur nga mjetet e mësimi , orënditë, objektet e deri te mos kualifikimi adekuat i mësimdhënësve që shtyn deri te mos efikasiteti në raport me nxënësin dhe mos interesimin e

---

<sup>57</sup> Halili.Ragip,Kriminologjia,Prishtinë,2011,f.277,280.

tyre për mësim, me çka pastaj vijojnë mungesat në shkollë, mos informimi i prindërve e deri të bredhja nëpër rrugë të fëmijëve në vend që ato të jenë në orar të mësimi. Si fillim fëmijët nuk janë të rregullt në mësim pastaj edhe mungesat e shumta që kjo dukuri bashkë me dukurin siç është **“shoqëria e keqe”** që është e njohur te ne , këto të dyja kur bashkohen atëherë fëmija fillon me disa veprime jo të pëlqyera si pirja e duhanit, pirja e drogave, vjedhjet e vogla, pastaj afrimi dhe njohja me persona të tretë e deri te grupet më të mëdhaja kriminale. Nga disa anketa që ekzistojnë shumica e kriminelëve që kanë deklaruar se fillimet e para të kriminalitetit i kanë filluar prej shkollës fillore dhe të mesme. Gjë që është e njejtë edhe në vendin tonë.

### **3.2. SHKAQET APO FAKTORËT SUBJEKTIV (TË BRENDSHËM)**

#### **3.2.1. SHPREHITË**

Si faktor i rëndësishëm subjektiv që ndikon ndaj individit për sjelljet dhe veprimet kriminale të cilat rrjedhin si pasoj e vetive biologjike dhe psikike do të përmendim shprehitë. Si veti psikologjike, shprehitë krijohen, zhvillohen dhe ndryshojnë, varësisht nga ndikimet e ambientit shoqërorë në të cilin jeton dhe formohet individi. Zakonisht, shprehitë dhe prirjet formohen nën ndikimin e vazhdueshëm të edukatës, raporteve shoqërore-ekonomike, kulturore dhe familjare.<sup>58</sup> Siç theksohet edhe më lart ndikim në krijimin e shprehive të individit në rend të parë ka familja dhe rrethi familjar, pastaj shkolla dhe rrethi më i gjerë, gjithashtu ndikim të madh kanë edhe mjetet e informimit publik dhe masmedia. Duke u ndikuar nga këto faktor fitohen shprehi nga individi të cilat shprehi mund të jenë të dobishme dhe pozitive e që janë të nevojshme për shoqërinë, mirëpo gjithashtu mund të fitohen edhe shprehi negative të cilat ndikojnë në sjelljet kriminale. Këto shprehi negative fitohen si shkak i gjendjes prej një kohe më të gjatë në ato rrethana dhe ambiente familjare , shoqërore, shkollore ku dominojnë rrethana, kushte, veti dhe sjellje të padëshirueshme apo prej kohës zhvillimit të individit prej moshës fëmijërore e deri në krijimin e personalitetit të pavarur. Normalisht se ky individ fiton shprehi që të kryej sjellje dhe vepra kriminale. Si veprime kriminale nga shprehitë më të njohura

---

<sup>58</sup> Halili.Ragip,Kriminologjia, Prishtinë,2011,faqe 344.

janë veprat e vjedhjes , mashtrimet , prishjet e rendit publik, përdorimi dhe shitja e drogave, marrja me prostitucion, e tjera. Si faktor subjektiv shprehinë kanë ndikim edhe ndaj kryerësve recidivist pasi që si pasoj e kësaj shprehje ato janë të prirur të përsërisin veprat e njëjta penale. Duke konsideruar shprehinë si faktor të rëndësishëm dhe që ka ndikim në personalitetin e individit edhe autor të njohur kanë trajtuar këtë çështje si Enriko Ferri, Garafallo, e tjerë.

### 3.2.2. INTELIGJENCA

Si veti subjektive e personalitetit që ka ndikim në sjelljet dhe veprat kriminale të individit është inteligjenca. Nëpërmjet inteligjencës individi është në gjendje të zgjedhë problemet e ndryshme jetësore që paraqiten dhe të njëjtat t'i mënjanoj apo të gjejë zgjidhje dhe duke u orientuar në situata të ndryshme.

Kësisoj psikologu i njohur amerikan **L.Terston** përmend shtatë faktor të inteligjencës:

1. *Aftësia e të folurit rrjedhshëm dhe gjetja e shprehjeve më adekuate, pra begatia e fjalorit,*
2. *Aftësia e të kuptuarit të përmbajtjeve të formulara me fjalë,*
3. *Aftësia e të operuarit me numra dhe veprime aritmetikore,*
4. *Aftësia e parafytyrimit dhe të mbajturit në mend të disa proceseve apo ngjarjeve,*
5. *Aftësia e të mbajturit mend – e memories dhe reproduktimit të përshtypjeve,*
6. *Aftësia e të perceptuarit të hapësirës , sendeve, dhe ndryshimeve që ndodhin në ambientin që rrethon, dhe*
7. *Aftësia e rezonimit apo e përkufizimit , përmbledhjes së raporteve , fakteve, të dhënave të ndryshme, me pak fjalë, kjo aftësi mbështetet me shprehjen koncize të përmbajtjeve të cilat janë të gjata.<sup>59</sup>*

Në zhvillimin e inteligjencës së individit ndikim të madh kanë kushtet dhe mënyra e jetesës, aktivitetet e tij në relacion me familjen, punën, rrethin shoqëror, arsimin , e tjerë.

---

<sup>59</sup> Halili.Ragip, Kriminologjia,Prishtinë,2011,faqe 346.

Kushtet e mira dhe solide ndikojnë në ngritjen e inteligjencës ndaj individit e në të kundërtën kushtet e vështira ekonomike dhe sociale rëndojnë zhvillimin e inteligjencës. Shumë kërkime shkencore kanë tentuar që nëpërmjet testeve të inteligjencës të përcaktojnë shkallën e inteligjencës të një personi, e që kanë rezultuar me fakte jo të sigurta. Kur jemi te veprat kriminale nuk mund të bëjmë një dallim apo të veçojmë se cila kategori e shkallës së inteligjencës janë kryerës të veprës kriminale. Ekzistojnë mendime se si kryerës të veprave penale dhe sjelljeve delikvente si pjesëmarrës në të shumtën e rasteve janë personat me inteligjencë më të ulët, kurse ato me inteligjencë normale dhe më të lartë janë më pak pjesëmarrës. Lirisht mund ta kundërshtojmë dhe mos pajtohemi me këto mendime pasi të dy kategorit e inteligjencës janë kryerës të veprave penale dhe sjelljeve kriminale, ku në këtë rast dallimi i vetëm ekziston në llojin e veprave penale që kanë kryer, ku sipas saj dallohet edhe shkalla e inteligjencës. Si për shembull, personat me inteligjencë më të ulët do të kryenin vepra penale si vjedhjet e imta, lëndime trupore, veprat kundër moralit, kundër jetës, kundër rendit shtetëror, e tjera. Kurse personat me inteligjencë më të lartë kryekëput kryejnë vepra kriminale ekonomike apo me përfitime financiare, siç janë veprat penale të krimit ekonomik, krimit kompjuterik, falsifikimet, trafikimi me drogë, trafikimi me armë, krimi i jakës bardhë, e tjera. Delikuentët me nivel më të lartë të inteligjencës janë të prirur që gjatë kryerjes së veprave penale të jenë të kujdesshëm dhe në mënyrë precize t'i kryejnë veprimet duke mos u vërejtur dhe duke mos lënë gjurmë me çka pamundësojnë apo pengojnë kapjen e tyre nga organet e rendit. Gjithashtu personat me inteligjencë më të lartë me veprimet kriminale paraqiten si organizator dhe planifikues të veprimeve duke shfrytëzuar aftësitë e tyre profesionale, suksesin e tyre ne karrierë, pozitat e ndryshme, dhe shkaqe tjera, kurse si kryerës të drejtpërdrejtë të veprimeve kriminale janë personat me inteligjencë të ulët si pasoj e mos kujdesit apo duke mos qenë të përgjegjshëm për veprimet që kryejnë.

### 3.2.3. ÇREGULLIMET MENDORE

Si faktor i brendshëm që ndikon ndaj individit të kryejë vepra penale janë edhe çrregullimet mendore. Më herët është menduar se çrregullimet mendore janë shkak kryesorë i delikuentit. Në jetën e përditshme flitet për njerëz që janë normal dhe të shëndoshë në pikpamje psikike dhe mentale, dhe për të tjerët që janë të sëmurë në këtë drejtim.<sup>60</sup> Personat me çrregullime mentale janë ato individ që kanë probleme, të njejtit ikin nga realiteti dhe rrinë të izoluar, ato janë mjaft të rezervuar dhe të tërhequr nga shoqëria, shkaqe që çojnë drejt sjelljeve kriminale. Në literaturën juridike si sëmundje psikike që përmenden më shumë janë **neurozat** që njihen si sëmundje psikike apo çrregullime të lehta, **psikopatitë** si çrregullime psikike të mesme dhe **psikozat** si çrregullime të rënda mentale. Personat me çrregullime mentale paraqiten si kryerës të veprave të ndryshme penale, mirpo nuk don të thotë se të gjithë të sëmurit psikik kryejnë krime dhe sjellje kriminale ku këtu ndikim të madh kanë edhe kushtet familjare, ekonomike-finansiare, shoqërore, e tjera. Prandaj personat e sëmurë psikik kanë trajtim të veçant ku edhe legjislacioni jonë këta persona i trajton si të veçant duke i konsideruar të papërgjegjshëm për sjelljet e tyre, ku në vend të sanksioneve penale ndaj tyre ka paraparë masa siguroese. Për përgjegjshmërin e këtyre personave me çrregullime mentale edhe kodi penal i Republikës së Maqedonisë është treguar i mëshirshëm , ku sipas nenit 12 thuhet:

*Nuk është i përgjegjshëm kryerësi i cili gjatë kohës së kryerjes së veprës penale nuk ka mundur ta kuptojë rëndësinë e veprës së vet apo nuk ka mundur t'i kontrollojë veprimet e veta për shkak të sëmundjes së përhershme apo të përkohshme shpirtërore për shkak të çrregullimit të përhershëm shpirtërorë ose të zhvillimit të ngecur shpirtërorë(papërgjegjshmërisë) ose të pengesave tjera të rënda shpirtërore.<sup>61</sup>*

Si masa siguroese që mund tu shqiptohen personave me çrregullime mentale për veprat e kryera penale, janë paraparë në nenin 61 të kodit penal të Republikës së Maqedonisë, dhe kto masa janë siç vijon:

<sup>60</sup> Halili,Ragip,Kriminologjia,Prishtinë,2011, faqe 362.

<sup>61</sup> Kodi Penal i Republikës Maqedonisë, neni 12.

- 1). *Mjekim i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucione shëndetësore,*
- 2). *Mjekim i detyrueshëm psikiatrik në liri,*
- 3). *Mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe i narkomanëve.*<sup>62</sup>

---

<sup>62</sup> Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, neni 61.

## IV - KAPITULLI I KATËRT

### MASAT PREVENTIVE DHE REPRESIVE PËR LUFTIMIN E KRIMINALITETIT.

#### 1. MASAT PREVENTIVE

##### 1.1. EDUKIMI FAMILJAR

Familja është grup themelorë i shoqërisë që, varësisht prej zhvillimit shoqërorë-ekonomik mbledh rreth vetes njerëz të lidhur me martesë dhe pasardhësit e tyre eventualisht një rreth më të gjerë ose më të ngushtë njerëzish të një gjaku ose me lidhje të tjera , të cilat bashkohen me qëllim që t'i kënaqin nevojat e veta të ndryshme biologjike, (lindjen dhe rritjen e fëmijëve) ekonomike, sociale, edukative, emotive etj.<sup>63</sup> Familja si grup shoqëror apo institucion është faktori bazë apo ombrella kryesore dhe më e rëndësishme në zhvillimin e personalitetit dhe formimit të njeriut e me theks të veçantë në lindjen dhe rritjen e fëmijëve. Detyra kryesore e familjes është që të kujdeset për fëmijët dhe anëtarët e vet prej lindjes e deri në pavarësimin e tyre në kuptimin e formimit si njeri, edukimin, ngritjen profesionale dhe zhvillimin në proceset jetësore. Edukimi familjar është preventivë kryesore për anëtarët e vet dhe në bashkësi për gjithë shoqërinë sepse me arritjen e edukimit të fëmijëve në mënyrë të denjë mundësohet që ato të jenë sa më larg kriminalitetit dhe larg viktimizimit, duke i edukuar drejtë dhe orientuar për një jetë normale të ndershme dhe me dinjitet. Familja është faktori parë që mund të ndikoj te anëtarët e vet nëse te ato vërehen shenjat e para të jo korrektësisë apo të pa dëshiruara dhe devijante dhe reagimi në kohë mund të ndihmoj në mënjanimin e këtyre veprimeve. Në kushtet tona bashkëkohore me globalizimin, urbanizmin, zhvillimi i shpejtë i teknologjisë dhe kushteve moderne në institucionin familje po krijohen dobësime dhe pengesa për edukim të drejtë. Kushtet ekonomike- sociale apo kryesisht ato financiare janë shumë të rëndësishëm pasi familjet me gjendje ekonomike të rënduar e kanë shumë më rëndë të merren me edukimin e anëtarëve si pasoj e mungesës së kushteve elementare për jetesë, kohës lirë dhe nevoja që

---

<sup>63</sup> Latifi.Vesel, Politika Kriminale, Prishtinë 2011, faqe 195.

kohën më të madhe duhet të jenë në marrëdhënie pune, me çka nuk mund të arrihet harmonia familjare. Statistikat tregojnë se delikuentët më së tepërmi vijnë nga familjet ekonomikisht të rënduara apo të dobëta, nga familjet e degraduara, shumë anëtarëshe, mungesa e njerit nga prindërit, papunësia dhe nga familjet me probleme. Prandaj themi se një familje në kuptimin e plot të fjalës është ajo e cila me të gjitha tiparet e duhura ka ndikim të madh në edukimin e anëtarëve të vet duke i edukuar dhe përgaditur psikologjikisht deri momentin kur bëhen të përgjegjshëm. Mirëpo në praktik nuk është vetëm roli i edukatës familjare që një anëtarë apo fëmijë të saj ta shtijë drejtë kriminalitetit sepse ajo ndërlidhet me shumë faktorë tjerë.

## 1.2. ARSIMIMI

Arsimimi është një faktor me rëndësi në formën dhe aftësimin e personalitetit të njeriut për jetë më të sigurt dhe më të suksesshme. Një kohë të gjatë është menduar se arsimimi është një mjet i fuqishëm për pengimin e sjelljeve devijante dhe kriminale. Qysh në kohën e mendimtarëve dhe filozofëve racionalist e iluminist, është theksuar se me anë të arsimimit të njerëzve luftohen shumë të këqija në shoqëri. Njeriu i arsimuar është më i aftë për të dalluar të keqen nga e mira. Personat e arsimuar me vështirësi mund të bien në ndikime negative. Ata janë të pajisur me dije dhe informata të shumta dhe e kanë më të lehtë të marrin qëndrime dhe sjellje pozitive.<sup>64</sup>

Autori i njohur **Enriko Feri** thekson *se “me rritjen e arsimimit në shoqëri kriminaliteti bije sepse njerëzit e arsimuar janë më të kujdesshëm , nuk janë injorant, më shpejtë i kuptojnë problemet shoqërore, ekonomike , politike.”*<sup>65</sup> Personat e arsimuar janë më të përgjegjshëm dhe kanë aftësi për të gjykuar drejtë prandaj merren më pak me sjellje kriminale. Kurse personat e pa arsimuar nuk mund të gjykojnë drejtë dhe shpejtë mund të manipulohen sepse nuk janë të aftë për të kuptuar pasojat e veprimeve kriminale. Edhe shkrimtari i njohur francez **Viktor Ygos** e përkrah idenë se arsimimi largon njerëzit nga kriminaliteti, ku thotë:

---

<sup>64</sup>Halili.Ragip, Kriminologjia, Prishtinë,2011,faqe260.

<sup>65</sup> Po aty,faqe260.



**“hapja e një shkolle do të thotë mbyllja e një burgu”<sup>66</sup>**. Nga kjo vlen të kuptohet se personat e pa arsimuar janë të prirur për të kryer vepra penale dhe se me arsimimin e tyre do të zvogëlohej kriminaliteti. Shkolla trajtohet si një institucion që ka forcë të madhe ndikuese, jo vetëm në aspektin e edukimit dhe të ngritjes kulturore, por edhe në aspektin e zhvillimit emocional dhe intelektual dhe në formimin e tërësishëm të strukturës së personalitetit të njeriut të ri.<sup>67</sup>

Shkolla është faktori i dytë kryesorë pasi fëmijët kalojnë një kohë të gjatë të ditës dhe aty mund të vërehen gjendjet apo veprimet jonormale për një fëmijë dhe në kohë duhet të intervenohet në korigjimin e sjelljeve fizike dhe psikike. Shkolla duhet të zhvilloj aktivitet arsimor, kulturor, edukativ, me plan-programe të cilat aftësojnë dhe edukojnë fëmijët. Përgjegjësia duhet të jetë e lartë dhe kujdesi i veçantë ndaj fëmijëve nga personeli që të njejtët mos mungojnë në orët mësimore dhe të bredhin rrugëve, me çka pamundësohet që ato të jenë më afër krimit. Të jenë të saktë në oraret mësimore, sepse shumica e delikuentëve janë fëmijë që fillimisht kanë bredhur prej orëve pastaj edhe e kanë lënë tërësisht shkollimin. Që efikasiteti të jetë edhe më i lartë duhet të ekzistoj bashkëpunimi familje dhe shkollë, me çka kontrolli do të jetë më i madh dhe më i mjaftueshëm, dhe në rast të nevojës edhe intervenimi është më i hershëm dhe i suksesshëm. Kemi edhe ide se shkollimi dhe arsimimi nuk kanë ndikim në pengimin e kriminalitetit sepse ka raste kur personat e arsimuar kryejnë vepra penale edhe më të rënda. Përkrahës i kësaj ideje është edhe **Rafaello Garafallo** i cili thotë se **“arsimi i aftëson dhe i armatos me dije personat të cilët pastaj ato dije i shfrytëzojnë për sjellje kriminale”**.<sup>68</sup> Kjo ide është e pranueshme sepse praktika e tregon atë se në botën bashkëkohore me zhvillimin e teknologjisë dhe transportit pjesëmarrja e personave me arsim në kriminalitet është i lartë sepse përgatitja e tyre profesionale dhe njohurit shkencore u mundësojnë kryerjen e veprave penale siç janë kriminaliteti i organizuar, i jakës së bardhë, kriminaliteti ekonomik, ai kompjuterik i cili është më aktual dhe i përhapur. Këto persona me lehtësi përdorin teknologjinë kompjuterike dhe teknikën bashkëkohore me çka arrijnë të futen nëpër llogarit bankare dhe transaksioneve të ndryshme të personave fizik dhe juridik, me çka bëhen

<sup>66</sup> Halili.Ragip, Kriminologjia, Prishtinë,2011,faqe260

<sup>67</sup> Latifi.Vesel, Politika Kriminale, Prishtinë,2011,faqe 198.

<sup>68</sup> Halili.Ragip, Kriminologjia,Prishtinë,2011,faqe260.

keqpërdorime dhe vjedhje të rënda. Mirëpo nga statistikat e bëra në praktikë përsëri tregon se personat që kryejnë më shumë vepra penale janë personat e pa arsimuar. Prandaj lirisht mund të themi se arsimi dhe shkollimi janë faktorë kryesorë në parandalimin dhe preventivën e krimit në shoqëri.

### 1.3. MJETET E INFORMIMIT

Mjetet e informimit ndahen sipas formës që janë të shkruara dhe elektronike. Në drejtim të aktivizimit të faktorit shoqëror për luftë kundër kriminalitetit dhe zhvillimit shoqëror antikriminal, rol i posaçëm i përket informimit të drejtë të qytetarëve në lidhje me dukuritë e sjelljes delikuede dhe kriminale në një mjedis. Një informim i tillë është më se i domosdoshëm në një shoqëri, në të cilën vet qytetarët bëjnë përpjekje për të njohur problemet e shoqërisë. Interesimi i tyre për zgjidhjen e këtyre problemeve është aq më i madh sa më shumë të jenë të informuar në mënyrë të përafërt dhe të saktë. Me të drejtë mund të thuhet se njohja dhe informimi janë kushte të domosdoshme për aftësimin e qytetarëve, të organeve shtetërore dhe të institucioneve për kryerjen e punëve të tyre shoqërore.<sup>69</sup>

Si mjete të komunikimit apo informimit konsiderohen shtypi, radioja, televizioni, filmi, interneti dhe të tjera të cilat janë bërë mekanizëm i fuqishëm që ndikojnë në informimin dhe orientimin e opinionit publik për një kohë shumë të shkurtër dhe të drejtpërdrejt. Mjetet e komunikimit masiv në botën bashkëkohore, janë bërë mjete të fuqishme të ndikimit dhe orientimit të opinionit brenda një vendi apo opinionit ndërkombëtarë.<sup>70</sup> Për ndryshe masmedia dhe propaganda janë një sferë shumë e rëndësishme në kohën bashkëkohore me zhvillimin dhe përsosjen e teknologjisë dhe të internetit, propaganda konsiderohet si arma kryesore e cila ndikon dhe arrin që të jetë sa më pranë dhe afër çdo individ. Për prapaskenën e masmedias flitet se shumë grupe luftojnë që të kenë në dorë televizionet dhe të ndikojnë te ata për programet dhe informatat e opinionit në sferat ekonomike, politike, kulturore e me radhë. Në formën e shkruar si mjet informimi e kemi shtypin, si mjet komunikimi ka ndikim në jetën

<sup>69</sup> Latifi.Vesel, Hysa.Vasylika, Elezi.Ismet, Politika e luftimit të kriminalitetit, Prishtinë,2012,faqe 298,299.

<sup>70</sup> Halili.Ragip, Penologjia, Prishtinë,2002, faqe 262.

politike, shoqërore, arsimore, sportive e tjera. Me anë të shtypit gjeneratat e reja marin informata me anë të cilave njohin vlera të reja, ndodhi, kuriozitetet, kolumna e tjera që ndikojnë pozitivisht në formimin dhe zhvillimin e personalitetit. Mirëpo në kohën bashkëkohore shtypi shumë pak përdoret mos themi se është lënë pas dore krejtësisht krejt kjo si pasojë e zhvillimit të teknologjisë informatike. Me daljen e internetit, gazetave dhe revistave online, rrjeteve sociale, lexuesit janë shumë më afër informatës dhe shumë shpejtë arrihet qasje dhe informim të drejtë dhe në kohë. Qasja online në gazetatat, revistat të informimit qofshin ato të lajmeve politike, shkencore apo zbavitëse kanë ndikim të madh në informimin e opinionit publik me çka mund të ndikoj në parandalimin e krimit apo edhe në përhapjen e saj. Informatat mund të jenë të nevojshme dhe produktive kur trajtohen vlera të shëndosha morale, artistike, zbavitëse, shkencore kurse nga ana tjetër mund të ndikojnë edhe negativisht duke përhapur krimin te gjeneratat e reja duke paraqitur vlera të pamoralshme me qëllime të përfitimeve dhe arritjen e qëllimeve të caktuara.

## **2. MASAT REPRESIVE**

### **2.1. ROLI I POLICISË**

Policia (politia-lat.) është organ shtetëror që kujdeset për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti, mbajtjen e rendit dhe të qetësisë publike si dhe sigurimin e rendit të caktuar shtetëror.<sup>71</sup> Si institucion shtetëror për ruajtjen e rendit shtetëror dhe qetësisë publike policia ekziston në të gjitha vendet dhe shtetet e botës ku përafërsisht në forma të njëjta ruan dhe kryen rolin e njejtë. Roli i saj është shumë i rëndësishëm që ka të bëjë me parandalimin e kriminalitetit ku nëpërmjet detyrave dhe përcaktimeve ligjore dhe metodave të caktuara paraqitet si faktor preventiv dhe represiv i kriminalitetit në shoqëri. Një ndër masat e policisë që ka karakter preventiv është patrullimi i shpeshtë me çka vihet në dukje pjesëmarrja e tyre në terren që ka ndikim ndaj njerëzve dhe shoqërisë në përgjithësi që ato të jenë më të kujdesshëm dhe në rast të ndodhive kriminale të jenë më afër krimit dhe gjurmëve. Masë tjetër është edhe

---

<sup>71</sup> Latifi.Vesel,Politika kriminale, Prishtinë,2011,faqe112.

sigurimi i objekteve dhe institucioneve kryesore me çka në raste normale por edhe në gjendje të protestave dhe mbledhjeve grupore të mund të mbrohet apo parandalohet krimi. Sigurimi i tubimeve, koncerteve, lojërave sportive është detyrë e policisë që duke bërë plane analitike dhe statistikore të sigurojnë terene me anë të cilave do të sigurohen kushte për mbarëvajtjen e tyre të rregullt dhe pa problem. Nga kompetencat që rrjedhin prej përcaktimeve ligjore policia është kompetente për dhënien e lejeve dhe dokumenteve personale me çka ka qasje në sistemin shtetëror për kontroll ndaj çdo personi që do të shërbej për identifikimin e kriminalitetit eventual. Masë tjetër efektive është edhe kontrolli dhe patrullimi në komunikacion ku arrihen dy qëllime njëri për ngritjen e vetëdijes qytetare dhe e dyta ndëshkimi i kryerësve të kundërvajtjeve me qëllim të ruajtjes së rendit dhe qarkullimit të lirë në komunikacion. Gjithashtu policia mer pjesë në ndërmjetësimin e zgjedhjeve të konflikteve në mes palëve që të mënjanojnë problemet dhe të mos eskalojnë situata në gjendje më të rënda. Që parandalimi ndaj kriminalitetit të jetë më efikas policia bashkëpunon me të gjitha organet e aparatit shtetëror siç janë prokuroria, gjykatat, organizatat e ndryshme, bashkëpunimi qytetar-policë, me çka në mes veti sigurojnë të dhëna, këmbëjnë informata për marrëdhënie të ndërsjella dhe reciproke.

Në të mirë të udhëheqjes së luftës së suksesshme kundër kriminalitetit, bashkëpunimi policor sendërtohet edhe në planin ndërkombëtarë nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpoli) nëpërmjet Këshillit Evropian, ndërmjet vet policive të disa vendeve dhe nëpërmjet formave tjera.<sup>72</sup> Në mes veti shtetet shkëmbejnë informata, asistojnë në rast nevojë, këmbëjnë të dhëna për procedurat dhe nevojat e ndërsjella. Bashkëpunimi edhe më tepër zgjerohet me anëtarësimin në organizatat e policisë si Interpoli, Europoli, e tjera. Këto bashkëpunime pothuajse janë të nevojshme për shkak të globalizimit dhe përparimit të mjeteve teknike dhe të komunikimit dhe transportit me çka kriminalitetit i mundësohet më lehtë të ushtrohet. Si formë për ndjekjen e kriminalitetit në bashkëpunim në mes shteteve është ndjekja e përbashkët e kriminalitetit dhe mbikëqyrjen e saj kur zbulojnë grupe kriminale që lëvizin në më shumë shtete dhe pas kapjes tyre nëpërmjet ekstradimit lehtësohet ndëshkimi i kriminelëve. Roli i policisë është shumë i rëndësishëm edhe në parandalimin represiv të

---

<sup>72</sup> Latifi.Vesel,Politika kriminale,Prishtinë,2011,faqe115.

kriminalitetit ku roli i tyre është të mbrojnë autoritetet gjyqësorë në këtë rast prokurorin dhe gjykatën që t'i kryejnë veprimet hetimore dhe gjyqësore. Edhe gjatë procedurave që kryen prokurori gjatë hetuesisë është shumë e nevojshme roli i policisë pasi ata sigurojnë vendin ndihmojnë në gjetjen e provave dhe kapjen e kriminalitetit. Nuk mund të ketë sukses lufta kundër kriminalitetit nëse organet shtetërore siç janë gjykata, prokuroria dhe organet tjera nuk kanë bashkëpunim të ndërsjellë dhe mirëfilltë me policinë. Kompetencat e policisë janë të parapara me ligj dhe ato nuk duhet të tejkalohen nga ana e organeve policisë dhe të keqpërdoren duke dalur jashtë kompetencave apo duke keqpërdorur pozitat e tyre. Në rrethin dhe shoqërinë tonë policia është e padëshirueshme dhe urehet në masë të madhe pasi ajo shihet vetëm si institucion dënues dhe ndëshkues. Kjo përshtypje rrjedh si rezultat i sistemit shtetërorë të mëhershëm që ka qenë komunizmi ku policia ka qenë totalitare dhe në shërbim të udhëheqësit. Edhe tani e kësaj dite edhe pse jemi në tranzicion ende nuk mund të fshihet ky ndikim, ku policia në këtë aspekt duhet të jetë më aktive dhe nëpërmjet paraqitjeve të tyre të tregon se ato janë ruajtës të qetësisë dhe rendit publik dhe se prania e tyre është në dobi të gjithë qytetarëve.

## **2.2. ROLI I PROKURORISË**

Prokuroria është organ shtetërorë i përcaktuar me ligj për luftimin e kriminalitetit që ka rol mbrojtës të ligjit dhe kushtetutës dhe njëkohësisht është përgjegjëse për ndjekjen penale të personave fizik dhe juridik për vepra penale. Për veç rolit parandalues prokuroria ka edhe rolin represiv të kriminalitetit e cila së bashku me gjykatën kanë rëndësi të veçantë. Në shumë vende dhe sisteme prokuroria është organ i pavarur kurse në disa shtete është pjesë e sistemit gjyqësorë. Kompetencat e saj janë të rregulluara me ligj dhe është përgjegjëse për ndjekjen penale të personave fizik dhe juridik të dyshuar për vepër penale. Prokuroria publike themelore e Tetovës është organ shtetëror unik dhe i pavarur i cili ka të drejtë dhe obligim t'i ndjek kryerësit e veprave penale në kuadër të kompetencave të saj. Përbërja e saj është e rregulluar në sistem hierarkik, kështu që prokurorët udhëhiqen nga prokurori publik themelor, kurse i njëjti për veprimtarin e tij përgjigjet përpara këshillit të prokurorëve publik themelor të

Republikës së Maqedonisë. Në pengimin dhe luftën kundër shkeljes së ligjit prokuroria është e obliguar t'i mbikëqyrë respektimin e ligjshmërisë dhe në kuadër të procedurës gjyqësore penale, gjatë shqiptimit të veprave penale nga ana e gjykatës.<sup>73</sup> Ai ka të drejtë të kryejë vet çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm për të vërtetuar praninë e veprës penale.<sup>74</sup> Me qëllim të zbulimit të kriminalitetit Prokuroria publike ka të drejtë për veç institucioneve shtetërore të kërkoj edhe informata apo dokumente të caktuara edhe nga qytetarët ose nga personat juridik. Gjatë vendimmarrjes Prokuroria mund të konsultohet edhe me personat zyrtar të fushave konkrete si edhe ka të drejtë që të bëj vetë këqyrjen e dokumenteve përkatëse në rast se të njëjtat nuk janë të dërguara nga ana e personave të caktuar në Prokurorin publike. Prokuroria publike ka për detyrë që në afat sa më të shkurtër, por jo më shumë se 30 ditë, nga dita e pranimit të kallëzimeve penale të ndërmarr veprime për të cilat është i autorizuar me ligj.<sup>75</sup>

### **2.3. ROLI I GJYKATAVE**

Paraprakisht folëm për rolin e policisë dhe prokurorisë për parandalimin represiv të kriminalitetit në shoqëri dhe në fund vjen në shprehje roli i gjykatës i cili paraqitet si organi i fundit i cili thënë me një fjalë kurorëzon punën apo harmonizon përpjekjet e arritura nga organet e lartpërmendura. Pra, në instancë të fundit gjyqi vendos që rastin konkret apo personin e dyshuar do ta shpall fajtor apo gjegjësisht do të caktoj masën e burgimit ose lirimin e të njëjtit nga akuza. Gjykatat janë organe shtetërore të pavarura të cilat ushtrojnë pushtetin gjyqësorë në bazë të përcaktimeve ligjore dhe kushtetutës. Praktika e saj mbështetet në zgjidhjet ligjore të shqiptimit të sanksionit me çka lufton kriminalitetin. Pushteti gjyqësorë në rendin juridik zë pozitën e tretë pas atij ligjvënës dhe pushtetit ekzekutiv të një shteti. Gjykata mbron të drejtat dhe liritë e qytetarëve të garantuara me ligj, të drejtat e personave juridik dhe të drejtat shtetërore.

---

<sup>73</sup> Latifi.Vesel, Politika kriminale,Prishtinë.2011,faqe.130.

<sup>74</sup> Po aty, faqe 130.

<sup>75</sup> Neni 39,alineja 3, Ligji per Prokurorinë publike,Gazeta zyrtare nr.150/07. 12.12.2007.

Në bazë të ligjit për gjykatat *“pushtetin gjyqësorë e ushtrojnë gjykatat në Republikën e Maqedonisë”* (neni1,parag.1) dhe *“Gjykatat janë organe shtetërore autonome dhe të pavarura”* (neni1,parag.2).<sup>76</sup>

Si parim bazë në punën e gjykatave apo në rastet e gjyqimit është pavarësia e gjykatave që nënkupton zgjidhjen e çështjes në mënyrë korrekte dhe se ato duhet të jenë të paanshme, objektive dhe sjelljen e vendimeve duhet ta bazojnë dhe mbështesin në fakte, prova në bazë të ligjit përkatës dhe bindjen e lirë të vet gjyqtarëve pa anime dhe ndikime qofshin politike apo të korrupsionit. Kuptimi dhe zbatimi i drejtë i këtij parimi në praktik është garancia kryesore për mbrojtjen e të drejtave të pjesëmarrësve në procedurë penale.<sup>77</sup> Roli i gjykatës në parandalimin represiv të kriminalitetit ka rëndësi të madhe pasi gjykata ka të drejtë eksplicite që kryerësin e veprës penale ta dënoj me burgim me çka në këtë rast arrihet që i njejtë të ndalohej që në të ardhmen mos e vazhdoj veprën penale dhe njëkohësisht të mos kryejë vepra penale të njëjta apo tjera. Me caktimin e masës së burgimit i dënuari i nënshtrohet procesit të risocializimit me çka arrihet edhe qëllimi kryesorë i vet dënimit me burgim. Për sa i përket pavarësisë së gjykatave në Republikën e Maqedonisë lirisht mund të themi se ky parim është i cenuar me vet faktin se kemi ndikim të politikës në marrjen e vendimeve gjyqësore apo kemi raste edhe të ndërhyrjes indirekte edhe të pushtetit e me çka shkelet e drejta e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatave. Edhe korrupsioni është i njohur dhe evident që ndikon në ndryshimin e vendimeve gjyqësore në favor të njëres apo palës tjetër, ku kjo gjendje shkel korrektësinë dhe pengon apo ndihmon në mënyrë negative ndaj luftimit dhe përhapjes së kriminalitetit.

#### **2.4. ROLI I INSTITUCIONEVE KOREKTUESE**

Roli i institucioneve korrektuese vjen në shprehje pasi që gjykata shqipton masën e dënimit me burg që u shqiptohet personave që kryejnë vepra penale, ku me shqiptimin e aktvendimit të njejtëve u pezullohet liria për një periudhë të caktuar kohore. Ekzekutimi i dënimit me heqje të lirisë apo dënimit me burgim nuk ka për qëllim ndëshkimin apo

<sup>76</sup> Ligji për gjykatat, neni1, paragrafi.1,2.

<sup>77</sup> Latifi.Vesel, Politika.Kriminale, Prishtinë.2011, faqe132.

retribucionin (hakmarrjen) ndaj delikuentit por qëllimi kryesorë është që i njëjti t'i nënshtrohet procesit edukativ dhe të arrihet risocializimi që pas edukimit në të ardhmen mos kryejë vepra tjera penale. Të ndikohet që ai të pendohet për veprën e kryer penale dhe pas mbajtjes së dënimit me procesin e risocializimit i njëjti të kthehet në rrethin shoqëror dhe familjar si person i dobishëm dhe i edukuar në respektimin e rregullave ligjore dhe normave shoqërore. Institucionet korrektuese mund të jenë të tipit të përgjithshëm, të përzier dhe të specializuara. Ekzistojnë ente të karakterit të përgjithshëm dhe të veçantë. Pastaj, entet sipas kriterit të moshës ndahen në ente ndëshkimore-përmirësuese për të rritur dhe në ente edukative-përmirësuese për të mitur, shikuar sipas gjinisë ka ente ndëshkimore-përmirësuese për meshkuj dhe ente ndëshkimore-përmirësuese për femra.<sup>78</sup> Në të gjitha sistemet bëhet ndarja e të miturve nga madhorët, dhe meshkujt nga femrat me qëllim të organizimit më normal të mbajtjes së rendit dhe si pasoj e kategorive të llojit jo të njëjtë.

Ekzistojnë tre lloje të burgjeve ato të tipit të mbyllur, gjysmë të mbyllur dhe të tipit të hapur. Në kohën bashkëkohore me qëllim të efektit dhe arritjes së qëllimit të përmirësimit dhe edukimit të burgosurve insistohet gjithnjë e më shumë që institucionet korrektuese të jenë apo të shëndrohen në lloje të spitaleve pasi në to dërgohen personat për shërim me nevojë të posaçme, siç janë shërimi i narkomanëve, alkoolistëve kategori që kanë prirje për kryerjen e veprave penale. Të njëjtit në këto spitale në mënyrë profesionale dhe kushte adekuate u nënshtrohen procedurave terapeutike me çka arrihet shoqërimi i të njëjtëve dhe njëkohësisht rehabilitimi i tyre. Në Republikën e Maqedonisë kushtet për këto lloje të organeve apo institucioneve korrektuese nuk janë në nivel të duhur sipas normave njerëzore dhe konventave ndërkombëtare për kushtet minimale nëpër burgje dhe në krahasim me shtetet evropiane ato janë shumë më të volitshme dhe solide me çka edhe efekti i procesit të edukimit dhe risocializimit në shtetin tonë arrihet me vështirësi. Si pasoj e kushteve në burgje që janë jo të mira për mos të thënë mizore, qelitë e burgjeve janë të mbipopulluara, mungojnë kushtet elementare për jetesë, kushtet higjienike, ushqimi i dobët dhe jo i shëndetshëm, mungesa e hapësirave për ushtrimin e profesioneve dhe punëve fizike, mungesa e hapësirave për lexim, biblioteka, mungesa e tereneve sportive për ushtrime dhe aktivitete fizike dhe rekreacion.

---

<sup>78</sup> Latifi. Vesel, Politika. Kriminale, Prishtinë, 2011, faqe 136.



Mungesa e këtyre kushteve pamundëson arritjen e qëllimit kryesor të vet dënimit që është procesi i risocializimit dhe rientegrimit. Nuk është e rastit që shpesh edhe Këshilli i Evropës rekomandon dhe kritikon qeveritë për mangësitë dhe gjendjen e mjerueshme të burgjeve në Republikën e Maqedonisë.

## PËRFUNDIMI

Dënimi me burg është një ndër format me anë të së cilës në pjesën më të madhe të rasteve e arrin qëllimin e duhur që kryerësi të marrë dënimin e merituar në bazë të veprës që ka kryer dhe i njëjti mos e përsëris në të ardhmen, ndërsa nga ana tjetër të tjerët të frikësohen mos kryejnë vepra të njëjta. Prandaj edhe praktika tregon se dënimi me burg si formë e dënimit në sistemin juridik është i suksesshëm në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit. Ky hulumtim shkencor paraqet të dhëna, informacione dhe konkluzione të cilat sfidojnë realitetin rreth kriminalitetit dhe dënimit me burg. U munduam që të paraqesim një formë dhe pasqyrë sa më reale rreth kësaj çështje duke e analizuar përcaktimin e saj në kodin penal të Republikës së Maqedonisë dhe të njëjtin duke e krahasuar me shtetet e rajonit me qëllim që të vërehen dallimet dhe ngjajshmërit në mes veti me shpresë se mund të merren si kritika, shembuj, korrigjime për përmirësime të mëtutjeshme. Tema në fjalë duhet të shërbejë si propozim për përmirësimin dhe ngritjen e cilësisë punës të gjyqësorit në përgjithësi e në veçanti në gjykatën themelore të Tetovës. Nga konkluzionet dhe statistikat e fituara që dolën nga të dhënat e mara nga arkiva e gjykatës themelore të Tetovës dhe nga enti për statistik i Republikës së Maqedonisë për vitet 2007 – 2012 vërehet një numër i madh i veprave penale të dënuar me burg me vendime të plotfuqishme, ku ky numër shqetësues prej 1256 rasteve është i lartë në krahasim me numrin e popullsisë në këtë rajon dhe shifër e cila nuk paraqet numrin real sepse ekzistojnë edhe shumë raste që ende nuk kanë një aktvendim nga shkaku i proceseve gjyqësore. Ideja në ngritjen e kësaj problematike është studimi i dënimit me burg me qëllim të paraqitjes dhe njohjes sa më të përafërt të saj, ngritjen e vetëdijes qytetare, të jenë të informuar edhe moshat e reja nga kjo dukuri që sa do pak të jenë të kujdesshëm dhe të mbrojtur nga kriminaliteti. Në hulumtimet e ardhshme të kësaj natyre shkencore mund të përfshihen edhe subjekte tjera të cilat mund të kontribuojnë më tepër në realitetin e kësaj fushe. Gjithashtu mund të paraqesë nxitje për kërkimet e ardhshme për problemet e paraqitura të cilat inspirojnë në hulumtime të njëjta apo të përafërta. Shpresojmë që ky punim do të ngrisë dënimin me burg si dukuri që në të ardhmen gjeneratat e reja të mësojnë nga e kaluara, të jenë të mbrojtur nga kriminaliteti dhe kjo dukuri të jetë në rënie.

## REKOMANDIMET

Nga ky hulumtim konstatimi im është se në praktikë dhe në përgjithësi për t'u zvogëluar kjo dukuri është e nevojshme që në mënyrë të vazhdueshme të shfrytëzohen praktikatat e vendeve më të zhvilluara në këtë drejtim ku gjithashtu edhe legjislacioni duhet të duroj dhe aplikoj ndryshime dhe modifikime nga sistemet juridike më të avancuara dhe më bashkëkohore. Në praktik duhen të ndërmerren aktivitete themelore që paraqesin bazë për edukimin e brezave më të rinj dhe ngritjen e vetëdijes qytetare me njohjen e problemit në fjalë që të njejtit të kontribuojnë për mënjanimin e kësaj dukurie dhe mbrojtjen nga e njëjta e cila trajtohet në këtë punim shkencorë. Institucionet shtetërore nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, shoqërinë civile dhe mjetet e informimit duhet alarmuar dhe ngritur më tepër në vetëdijen e qytetarit me çka mbrojtja dhe zvogëlimi i kriminalitetit do të jetë më i sigurt. Edhe pse procedurat komplekse dhe në praktik paraqesin problematik duhet që në aspekt institucional të ketë mbikqyrje më të lartë dhe më të avancuar ndaj gjyqësorit me qëllim të përkrahjes dhe nxitjes të njëjtës për efikasitet të punës e konkretisht përfundimit të lëndëve në afatet e duhura kohore duke respektuar parimet dhe vlerat juridike.

## LITERATURA

### -I- Libra, monografi dhe punime kërkimore shkencore.

1. Kambovski , Vllado, " E drejta penale. Pjesa e Përgjithëshme", Shkup, 2007.
2. Камбовски,Владо, Коментар на Кривичниот закон на Република Македонија,Интегрален текст,Скопје,2011.
3. Zejneli,Ismail, E drejta Penale Pjesa e Posaçme,Tetovë,2007.
4. Zejneli, Ismail, Delikuenca e të miturve në RM,Tetovë,2016.
5. Beqiri,Mitasin."Organizimi dhe gjendja e institucioneve penitensiare në Republikën e Maqedonisë".Tetovë,2007.
6. Puhan,Ivo ," E drejta romake" Prishtinë, 1980.
7. Salihu,Ismet,"E drejta penale ,pjesa e përgjithshme" Prishtinë, 2008.
8. Проевски,Ванчо,"Кривично право,општ дел",Скопје, 1986.
9. Halili, Ragip "Kriminologjia", Prishtinë, 2011.
10. Halili,Ragip," Viktimologjia, Prishtinë, 2007.
11. Halili , Ragip, " Penologjia", Prishtinë, 2011.
12. Sulejmanov, Zoran "Penologjia" , Shkup ,1999.
13. Ukaj, Bajram: "Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë", Prishtinë, 2006.
14. Хорватич,Желјко" Казнено право,опци дио", Загреб, 2003.
15. Gruda, Zejnullah ," Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut", Prishtinë, 2007.
16. Gruda ,Zejnullah ,"E drejta ndërkombëtare publike",Prishtinë,2007.
17. Latifi,Vesel "Politika kriminale", Prishtinë, 2011.
18. Latifi,Vesel "Kriminalistika", Prishtinë,2006 .
19. Hysa,Vasilika "Kriminologjia" Tiranë,2005.
20. Elezi,Ismet. Hysa,Vasilika "Politika kriminale",2011.
21. Elezi,Ismet,Mbrojtja juridike penale e pasurisë,Tiranë,2002
22. Gashi,Rexhep "Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri" Prishtinë,2001.

23. Sahiti,Ejup.Zejneli,Ismail, "E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë", Tetovë, 2017.
24. Sahiti, Ejup,"Argumentimi në procedurë penale", Prishtinë,1999.
25. Sahiti,Ejup, Psikologjia gjyqësore,Prishtinë,2007.
26. Osmani,Afrim,Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, Shkup, 2013.
27. Osmani,Afrim, Kodi penal, Shkup, 2010.
28. Наташа, Петровиц , кривично право, Београд,2008.

**-II- Kushtetuta, kode, ligje, akte ndërkombëtare dhe akte tjera.**

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Shkup, Nr.08-4642/1, me ndryshimet dhe plotsimet e vitit 2009.
2. Kodi penal i R.Maqedonisë, Shkup, 1996, me ndryshimet dhe plotësimet e vitit 2006 (Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë, nr.62/06).
3. Kodi penal i R. Kosovës, Prishtinë, 2013.
4. Kodi penal i R. Shqipërisë, Tiranë, 2010.
5. Kodi penal i R.Kroacisë.
6. Kodi penal i R.Sërbisë.
7. Kodi penal i R.Malit Zi.
8. Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale të R.M- së, Shkup, 2006(Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë,Nr.2/06).
9. Ligji mbi procedurën penale të R.M- së, Shkup, 1996,2005 (Gazeta zyrtare e R.Mqedonisë, Nr.15/05).
10. Ligji për kundërvajtje i R.Maqedonisë, Shkup, 2006(Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë,Nr.62/06).

11. Ligji për gjykata i R.Maqedonisë, Shkup,2006(Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë, Nr.58/06).

12. Ligji mbi prokurorin publike i R. Maqedonisë, Shkup 2003(Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë, Nr.60/03).

13. Ligji për punë të brendshme.

14. Rekomandimi nr.89/12 i Këshillit të Evropës mbi edukimin në burgje . Strasburg, 1987.

15. Rekomandimi i Këshillit të Ministrave për shtetet antare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve , 2006.

16. Rregullat minimale standarte të OKB-së për trajtimin e të burgosurve.

17. Konventa evropiane për parandalimin e torturës , trajtimit dhe dënimit johuman ose degradues. Strasburg,1987.

18. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut i Republikës së Maqedonisë , raporti vjetor 2008, Shkup.

### ***Aktet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut***

1. Karta e madhe e lirive e vitit 1215, Londër
2. Ligji për të drejtat ( Bill of right's) e vitit 1689, Londër
3. Kushtetuta e Virgjinisë e vitit 1776, SHBA

### **-III- Praktika gjyqësore**

1. Vendime të plotëfuqishme të Gjykatës Themelore të Tetovës për vitet 2007-2012.
2. Statistika dhe evidenca për rastet e dënuara me burgim nga arkiva e gjykatës themelore të Tetovës për vitet 2008 deri 2012.
3. Të dhëna statistikore nga Sektori i Punëve të Brendshme në Tetovë për vitet 2007-2012.

4. Statistika dhe evidenca nga Enti shtetëror për statistik i Republikës së Maqedonisë.

**-IV- Interneti**

1. [www.stat.gov.mk](http://www.stat.gov.mk)
2. [www.pravda.gov.mk](http://www.pravda.gov.mk).
3. [www.pravo.org](http://www.pravo.org).
4. [www.library.seeu.edu.mk](http://www.library.seeu.edu.mk)

*Këtë mund ua kushtoj gjyshit dhe prindërve të mi, dhe me të dua t'i nderoj për urtësinë, dashurinë dhe përkrahjen e rezervë që më ndihmuan në arritjen e suksesit tim.*

*Ju faleminderit.*